

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XXI, nr. 6373  
E mërkurë, 28 korrik 2021  
çmimi 0.40 €

Rriten rastet me Covid  
në Kosovë, 42 raste  
për 24 orë | FAQE 3



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH  
www.awr-abbruch.de

ANALISTËT POLITIKË KANË KOMENTUAR PROPOZIMET E KRYEMINISTRIT  
ALBIN KURTI RRETH DIALOGUT KOSOVË - SERBI | FAQE 4-5

## ANALISTËT: PROPOZIMET E KURTI, NË SHPËRPTHJE ME QËNDRIMET E NDËRMJETËSUESIT



### AKTUALE



GJENDJA E SIGURISË NË  
KOSOVË, STABILE | F. 3

BASHKATDHETARI DHURON  
NJË AUTOAMBULANCË PËR  
KOMUNËN E SKENDERAJT | F. 5

NË KLINIKËN E  
KIRURGISË TORAKALE PËR  
GJASHTË MUAJ U KRYEN  
180 OPERACIONE | F. 5



### EKONOMI

DOGANA SHËNON REKORD NË  
TË HYRA, MBLODHI MBI 700  
MILIONË EURO | F. 8

MINISTRIA E BUJQËSISË  
KËRKON NGA FERMERËT QË  
MOS T'I DJEGIN HAMULLORET | F. 8



Zbulohet  
pllaka  
përkujtimore  
për 21 zyrtarët  
policorë të  
rënë në krye  
të detyrës | FAQE 3



Avokati:  
Shoferi nuk më  
tha se e kishte  
zënë gjumi | FAQE 2



**RENOVA**  
PUTZ  
Maqedoni  
Xhepcisht - Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.PK.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegji.biznesi.com](http://www.kolegji.biznesi.com)  
info@kolegji.biznesi.com  
030 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...



## Avokati: Shoferi nuk më tha se e kishte zënë gjumi

PRISHTINË, 27 KORRIK - Shoferit të autobusit që u aksidentua më 25 korrik në Kroaci, të martën iu shqiptua masa e paraburgimit prej 30 ditësh, njoftuan autoritetet kroate. Masa e paraburgimit u shqiptua nën arsyetimin se ka rrezik që shoferi, 52-vjeçar, shtetas i Kosovës, mund të arratiset.

Gjykatësi i rastit, Mille Solldo, ka theksuar për mediat se Kroacia dhe Kosova kanë marrëveshje bashkëpunimi për çështje penale, por kjo marrëveshje nuk parasheh ekstradimin e shtetasve kosovarë dhe kjo është arsyeja pse është caktuar masa e paraburgimit. "Procedurat do të zhvillohen në Kroaci por, sipas marrëveshjes midis Kosovës dhe Kroacisë, ekziston mundësia

ligjore që procedura të zhvillohet edhe në Kosovë. Por, për këtë duhet pajtimi i të dyja shteteve. Mbrojtja mund ta kërkojë këtë, por propozimi për këtë çështje duhet të vijë nga shteti", ka deklaruar ai, raporton Rel.

Gjykatësi Solldo ka shtuar se, po ashtu, pritet që të merren në pyetje disa dëshmitarë. Ndërkaq, zëvendësprokurori i Shtetit për qarkun Sllavonski Brod, Franjo Kopuniq, ka thënë se shoferi tani do të dërgohet në burg. "Ai është deklaruar sot vetëm rreth paraburgimit dhe nuk dha asnjë dëshmi", ka pohuar për gazetarët Kopuniq.

I pyetur se pse shoferi në deklaratën paraprake ka thënë se ishte i lodhur dhe i paafat për ta drejtuar automjetin dhe pastaj u



mbrojt në heshtje gjatë marrjes në pyetje, Kopuniq ka thënë se ky konstatim erdhi nga mënyra në të cilën u krye, nga gjurmët e gomave dhe të gjitha rrethanat e tjera.

Kopuniq konfirmoi se do të kërkojë një ekspertizë e detajuar

e autobusit.

Shoferi do të mbrohet nga dy avokatë: Igor Cishper dhe Lubo Pavasoviq Viskoviq. "Në asnjë moment ai nuk më tha se e ka zënë gjumi", u tha Cishper gazetarëve.

Shoferi gjatë së hënës, para

autoriteteve kroate, u mbrojt në heshtje.

Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, e ka shpallur të hënën ditë zie shtetërore, pas aksidentit me autobus në Kroaci, ku mbetën të vdekur dhjetë pasagjerë (nëntë bashkatdhetarë dhe njëri nga shoferët e autobusit), kurse mbi 40 të lënduar, 15 prej tyre në gjendje të rëndë shëndetësore. Autobusi me targa të Kosovës që bartte 67 pasagjerë ka dalë nga rruga në autostradën afër Sllavonski Brodit në Kroaci, rreth orës 6:00 të mëngjesit të së dielës. Ministria e Punëve të Jashtme dhe e Diasporës (MPJD) ka njoftuar se të vdekurit janë bashkatdhetarë të cilët kanë qenë duke udhëtuar në linjën e rregullt Frankfurt - Prishtinë.

## Një person i vdekur, katër të zhdukur pas shpërthimit në Gjermani



LEVERKUZEN, 27 KORRIK - Një person ka vdekur dhe katër të tjerë janë zhdukur si pasojë e një shpërthimi të madh në një park industrial në qytetin gjerman Leverkusen. Kompania menaxhuese, Currenta, ka thënë "se ekipet e shpëtimit do ta vazhdojnë punën me të gjitha kapacitetet" për t'i gjetur punëtorët e zhdukur. "Ne jemi thellësisht të prekur nga ky aksident tragjik dhe vdekja e një punëtori", ka thënë kompania. Shpërthimi ka nxitur alarm për "rrezik ekstrem", si dhe ka shtyrë zyrtarët që t'u bëjnë thirrje banorëve që të mbyllin brenda dhe t'i mbyllin dritaret. Chempark ka brenda vetes kompani të mëdha kimike,

përfshirë Bayer dhe Lanxess. Currenta ka thënë se shpërthimi i 27 korrikut ka ndodhur në një zonë ku digjen mbeturinat. Sipas saj, zjarri tashmë është shuar. Ende askush nuk e di çfarë e ka shkaktuar shpërthimin. Në disa pamje në rrjetet sociale është parë tym i madh duke dalë nga zona kimike. Policia në qytetin e afërt, Këln, ka njoftuar në "Twitter" se është duke mbyllur disa autostrada në zonën në Leverkusen për shkak të "dëmit të madh". Banorët kanë thënë se zhurma është dëgjuar nga distanca dhe se disa dritare kanë kërcitur nga shpërthimi i fuqishëm.

## Partitë nga Republika Sërpska bojkotojnë institucionet e Bosnjës për shkak të mohimit të gjenocidit

Sarajevë, 27 korrik - Përfaqësues të partive politike nga Republika Sërpska kanë marrë vendim që, nga dita e hënë, 26 korrik, nuk do të marrin pjesë në punime dhe vendimmarrje të institucioneve

shtetërore të Bosnje-Hercegovinës, apo në parlamentin e këtij shteti, Këshillin Ministror dhe kryesinë e Bosnje-Hercegovinës. Këtë vendim e kanë marrë liderët e partive nga Republika Sërpska

gjatë një takimi në Banja Llukë, pas vendimit të Përfaqësuesit të Lartë Ndërkombëtar, Valentin Inzko, me të cilin është ndryshuar Kodi Penal i këtij shteti e, në bazë të të cilit, dënohet mohimi i gjenocidit

dhe glorifikimi i kriminelëve të luftës.

Përfaqësues të partive nga Republika Sërpska, entitet në Bosnje-Hercegovinë, kanë thënë se nuk e pranojnë vendimin e Inzkos.



## Nju-Jorku rrit përpjekjet për nxitje të vaksinimit

NJU-JORK, 27 KORRIK - Kryetari i qytetit të Nju-Jorkut, Bill de Blasio, ka thënë se gjysma e shtatorit është afati i fundit për të gjithë punëtorët që të vaksinohen kundër koronavirusit, në kundërtën do të duhet të bëjnë teste çdo javë, për të parë nëse janë

negativë në të. Vendimi i tij pritet ta rritë presionin për vaksinim të më shumë se 300 000 punëtorë të Nju-Jorkut, përfshirë mësues dhe zyrtarë policorë. Në këtë periudhë, po ashtu, nis mësimi nëpër shkolla. "Kjo ka të bëjë me rimëkëmbje. Ka të bëjë me atë

që kemi nevojë të bëjmë për ta kthyer sërish Nju-Jorkun si ka qenë. Ka të bëjë me mbajtjen e njerëzve të sigurt", ka thënë ai. Vendimi nuk përbën detyrim për vaksinim, mirëpo de Blasio ka inkurajuar sektorin privat që të nxisë sa më shumë vaksinimin.





# Zbulohet pllaka përkujtimore për 21 zyrtarët policorë të rënë në krye të detyrës

Që nga themelimi i Policisë së Kosovës, 21 vjet më parë, 21 zyrtarë policorë kanë dhënë jetën në krye të detyrës. Të martën u nderua vepra heroike e të gjithë zyrtarëve policorë, burra dhe gra të vendit me vendosjen e pllakës përkujtimore për zyrtarët policorë që ranë duke luftuar krimin e duke mbrojtur territorin dhe sovranitetin e Republikës së Kosovës

EPOKA  
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 27 KORRIK - Në ambientet e Policisë së Kosovës është mbajtur të martën ceremonia përkujtimore për 21 policët heronj që ranë në kryerje të detyrës duke dhënë nga vetja më sublimen, atë më të shtrenjtën, jetën e tyre. Gjatë ceremonisë u bë zbulimi i pllakës përkujtimore për 21 heronjtë e Policisë së Kosovës. Të pranishëm në këtë ceremoni ishin kryetari i Kuvendit të Kosovës, Glauk Konjufca, kryeministri Albin Kurti, zëvendësministri i Punëve të Brendshme, Blerim Gashani, drejtori i përgjithshëm i Policisë së Kosovës, Samedin Mehmeti, zëvendëskomandanti i FSK-së, Enver Cikaqi, ambasadorë dhe atashë. Vend të veçantë në këtë

organizim zunë familjarët e të rënëve duke i dhënë nder, respekt dhe madhështi kësaj ngjarjeje.

Drejtori i përgjithshëm i Policisë së Kosovës, Samedin Mehmeti, ka thënë se do t'u jenë përjetë mirënjohëse kontributit dhe sakrificës së secilit hero.

Kryeministri Kurti ka thënë se Policia e Kosovës është institucion i dalë nga lufta jonë çlirimtare. "Rrënjët e saj, ashtu si ato të ushtrisë sonë, gjenden te lufta çlirimtare dhe te lëvizjet e rezistenca shekullore e popullit tonë për liri", ka deklaruar Kurti.

Ai ka theksuar se në vitet e pasluftës Policia e Kosovës ka qenë një prej institucioneve shtetërore më të rëndësishme për vendosjen e ligshmërisë, pa të cilën nuk mund të ketë pavarësi e drejtësi. "Është nder dhe krenari që në



dhjetëvjetorin e rënies së Enver Zymberit, jam këtu në mesin tuaj, në ceremoninë e 'Zbulimit të pllakës përkujtimore në nderim të të gjithë policëve të rënë në krye të detyrës'.

Jorastësisht kemi zgjedhur ditën e rënies së tij për t'i kujtuar të gjithë policët e rënë në krye të detyrës në Kosovën e çliruar. Enver Zymberi është simbol i sakrificës për

integritet territorial dhe sovranitet shtetëror, për një Kosovë të lirë, demokratike, të pavarur me shtet të drejtë për të gjithë", ka thënë kryeministri Kurti.

## Gjendja e sigurisë në Kosovë, stabile



PRISHTINË, 27 KORRIK (ER) - Komisioni për Mbikëqyrjen e Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë ka mbajtur të martën mbledhjen e radhës të kryesuar nga kryetarja e këtij komisioni, Ganimete Musliu. Në këtë mbledhje, për gjendjen e sigurisë në vend, ka raportuar drejtori i Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë (AKI), Petrit Ajeti. Ai ka raportuar në këtë komision me dyer të mbyllura, pa praninë e mediave. Pas takimit, deputetja Musliu ka thënë se drejtori i AKI-së u ka thënë se në përgjithësi gjendja e sigurisë në vend është stabile

dhe nuk ka vend për shqetësime. "Sot kishim në raport të rregullt për gjashtëmuorin e parë të vitit drejtorin e Agjencisë për Inteligjencë, Petrit Ajeti dhe është raportuar në përgjithësi për punën, aktivitetin e AKI-së dhe gjendjen e sigurisë në vend. Duke u bazuar në informatat që janë marrë nga z. Ajeti si drejtor i kësaj agjencie, gjendja e sigurisë në vend është stabile dhe nuk ka hapësirë për shqetësime ose për ndonjë shqetësim shtesë te qytetarët e Kosovës", ka thënë Musliu.

## Rriten rastet me Covid në Kosovë, 42 raste për 24 orë

PRISHTINË, 27 KORRIK (ER) - Në Kosovë u konfirmuan të martën 42 raste të reja me Covid-19. Rastet pozitive rezultuan pas testimit të 2 987 mostrave, ka njoftuar Ministria e Shëndetësisë e Kosovës, duke u thirrur në të dhënat e Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike. Sipas njoftimit, në 24 orët e kaluara u shëruan 16 pacientë, ndërsa

raste aktive mbeten 195. Kosova ka konfirmuar gjithsej 108 073 raste pozitive me koronavirus. Prej këtyre, 2 265 pacientë kanë vdekur dhe 105 613 janë shëruar. Deri të martën në Kosovë janë dhënë 374 190 vaksina kundër koronavirusit, prej tyre 16 199 në 24 orët e fundit. Me dy doza të vaksinës janë

vaksinuar gjithsej 117 382 qytetarë. Vaksinimi masiv në Kosovë ka nisur më 15 qershor. Të gjithë qytetarët mbi 18 vjeç mund të regjistrohen dhe të imunizohen. Qeveria e Kosovës ka thënë se ka prioritet vaksinimin e 60 për qind të qytetarëve deri në fund të vitit.







ANALISTËT POLITIKË KANË KOMENTUAR PROPOZIMET E KRYEMINISTRIT  
ALBIN KURTI RRETH DIALOGUT KOSOVË - SERBI

# Analistët: Propozimet e Kurtit, në shpërputhje me qëndrimet e ndërmjetësuesit

Njohësit e procesit të dialogut Kosovë - Serbi kanë thënë se propozimet e kryeministrit Albin Kurti rreth dialogut Kosovë - Serbi kanë qenë në shpërputhje me qëndrimet e ndërmjetësuesit të këtij procesi. Ata kanë deklaruar se këto propozime kanë qenë legjitime, por nuk janë pranuar nga BE-ja. Sipas tyre, sado përmbajtjesore që mund të jenë propozimet, ato mund të shihen si frenuese të procesit të dialogut nëse nuk pranohen nga ndërmjetësuesi i dialogut

**EPOKA E RE**

**Muhamet KOCI**

**PRISHTINË, 27 KORRIK** - Njohësit e procesit të dialogut Kosovë - Serbi kanë treguar arsyet pse janë refuzuar propozimet e kryeministrit Albin Kurti në dialogun Kosovë - Serbi. Ata kanë bërë me dije se këto propozime janë në shpërputhje me qëndrimet e të dërguarit të posaçëm të Bashkimit Evropian për dialogun Kosovë - Serbi, Miroslav Lajçak.

Profesori i marrëdhënieve ndërkombëtare, Ibrahim Gashi, ka thënë për gazetën "Epoka e re" se sado përmbajtjesore që

mund të jenë propozimet, ato mund të shihen si frenuese të procesit të dialogut nëse nuk pranohen nga ndërmjetësuesi. "Propozimet duhen parë, siç thashë, të mira nëse pranohen nga ndërmjetësit, ani pse mund t'i kundërshtojë pala serbe, por nëse këto propozime nuk pranohen as nga ndërmjetësit (BE-ja dhe ShBA-ja), atëherë do të thotë se ato kërkesa, sado përmbajtjesore që mund të jenë, do të shihen si frenuese të procesit të dialogut", ka deklaruar Gashi.

Ai ka bërë me dije se pala e Kosovës duhet të bëjë kujdes që të mos bëhet penguese e këtij

procesit. "Sipas mendimit tim, pala e Kosovës nuk duhet të shpallet frenuese e procesit nga ana e ndërmjetësve ndërkombëtarë, sepse kjo mund të ketë pasoja për ne, siç i kemi parë në një të kaluar jo të largët kur ne u akuzuam se do ta bllokojmë dialogun për demarkacionin dhe për taksën. Nuk jam në mesin e atyre që mendojnë se dialogu ka alternativë dhe se shtetet mike duhet të mos përzihen në punët tona. Të dyja këto qëndrime i konsideroj gabime kardinale", ka deklaruar Gashi.

Edhe drejtori i IKD-së, Ehat Miftaraj, ka theksuar se

propozimet e kryeministrit Albin Kurti në Bruksel kanë qenë në kundërshtim me qëndrimet e BE-së. "Takimi i parë dhe takimi i dytë në mes të kryeministrit Kurti dhe presidentit Vuçiq më tepër mund të karakterizohen si takime njoftuese në mes dy aktorëve sesa që kanë prodhuar diçka konkrete. Propozimet dhe qasja e kryeministrit Kurti dhe presidentit Vuçiq janë në shpërputhje me qëndrimet dhe kërkesat e përfaqësuesit të BE-së, z. Lajçak, të cilit, së paku deri më tani, si duket, i ka dalë nga kontrolli menaxhimi i këtij procesi", ka thënë Miftaraj për gazetën "Epoka e re. Ai ka deklaruar se kërkesat e kryeministrit të Kosovës në këto takime kanë qenë legjitime. "Përderisa kërkesat e kryeministrit Kurti janë legjitime dhe mund të gjejnë përkrahje të gjerë popullore, të njëjtat nuk është se janë në linjë të plotë me rrjedhën dhe agjendën e përgatitur nga BE-ja dhe

përkrahur edhe nga ShBA-ja. E njëjta vlen edhe për presidentin Vuçiq, i cili tanimë dialogun, si duket, ka filluar të shfrytëzojë si fushatë parazgjedhore", është shprehur ai.

**Në shtator do të ndryshohet dinamika e procesit**

Njohësit e këtij procesi kanë paralajmëruar se dinamika e dialogut Kosovë - Serbi do të ndryshojë në muajin shtator. Sipas tyre, ndërmjetësuesi nuk do t'i tolerojë palët që të vazhdojnë të mos pajtohen për asgjë në këtë proces. "Nuk e di sa mund të vazhdojmë kështu, duke ditur se shtetet mike të Kosovës po kërkojnë me ngulm lëvizje në procesin e dialogut. Është herët të prognozojmë çfarë mund të jenë pasojat e këtij pozicionimi intarsigjent të palëve", ka thënë profesori i marrëdhënieve ndërkombëtare,



Ibrahim Gashi. Kurse drejtori i IKD-së, Ehat Miftaraj, ka thënë se kërkesat e BE-së dhe të ShBA-së do të ndryshojnë nga muaji shtator. “Përderisa BE-ja ka pasur durim në dy takimet e para, takimi i shtatorit me siguri se do të ndryshojë në substancë dhe në kërkesat që mund të vijnë si nga BE-ja ashtu edhe nga përfaqësuesi i ShBA-së, z.

Palmer, të cilët dyshoj se mund të tolerojnë takime të këtij niveli, ku shpenzohet shumë kohë dhe energji në tema të cilat largojnë palët nga një marrëveshje eventuale”, ka thënë ai. Sipas Miftarajt, mosndryshimi i dinamikës së këtij procesi do ta minonte edhe autoritetin e të dërguarit të posaçëm të Bashkimit Evropian për dialogun Kosovë - Serbi,

Miroslav Lajaçk. “Një takim i muajit shtator i njëjtë me dy takimet e para do ta minonte në masë të madhe autoritetin e z. Lajaçkut si person kompetent dhe që është në gjendje të kontrollojë dhe t'i përcaktojë temat që mund të promovojnë arritjen e një marrëveshje mes palëve”, është shprehur ai. Deri më tani kryeministri Albin Kurti ka zhvilluar dy takime në

Bruksel me presidentin e Serbisë, Aleksandër Vuçiq. Në të dy këto takime Kurti ka bërë disa propozime të cilat janë refuzuar nga BE-ja dhe Serbia. Në takimin e parë, i cili është mbajtur më 15 qershor, Kurti ka bërë katër propozime. Propozimi i parë ka qenë që gjashtë shtetet e Ballkanit Perëndimor të avancojnë CEFTA-n në SEFTA (South-East

European Free Trade Agreement) sipas modelit të EFTA-EEA. Propozimi i dytë ka qenë që Kosova dhe Serbia të nënshkruajnë një marrëveshje të përbashkët të paqes, duke u zotuar se nuk do ta sulmojnë njëra-tjetrën. Sipas propozimit të tretë të kryeministrit, pas njohjes së ndërsjellë midis Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë, të dyja vendet do të duhej të kishin reciprocitet bilateral, përfshirë çështjen e pakicave. Në propozimin e katërt Kurti kishte përfshirë çështjen e të pagjeturve. Pas takimit kryeministrit Kurti ka treguar se propozimet e tij janë refuzuar.

Ndërsa në takimin e dytë, i cili është mbajtur më 19 korrik, Kurti ka propozuar Deklaratë të Paqes në mes të dy vendeve. “Në takimin e dytë me delegacionin e Serbisë në Bruksel, sot ofruam një Deklaratë të Paqes me gjashtë nene, të balancuar edhe në gjuhën angleze, e cila flet për zotimin për mosulmim të njëri-tjetrit dhe për reciprocitet të drejtave. Po ashtu, ofruam edhe dëshmi të 11 shkeljeve që i bën Serbia ndaj Kosovës përmes barrierave kundër tregtisë së lirë e që do të duhej të eliminohehin. U refuzuan të dyja këto”, ka thënë Kurti pas takimit.



## Në Klinikën e Kirurgjisë Torakale për gjashtë muaj u kryen 180 operacione

PRISHTINË, 27 KORRIK (ER) - Drejtori përgjithshëm i Shërbimit Spitalor Klinik dhe Universitar të Kosovës (ShSKUK), Valbon Krasniqi, bashkë me Agreta Gashi, kryesuese e bordit drejtues të Shërbimit Spitalor Klinik dhe Universitar të Kosovës, kanë mbajtur takim pune me kolegjiunin e Klinikës së Kirurgjisë Torakale, ku janë informuar lidhur me punën që po bëhet në këtë klinikë, sukseset, sfidat dhe kërkesat që kanë profesionistët shëndetësorë të kësaj klinike.

Nazmi Kolgeci, u. d. drejtor i Klinikës së Kirurgjisë Torakale, i njoftoi ata lidhur me punën që është bërë në këtë klinikë, ku vetëm në gjashtëmuajorin e parë të

këtij viti, përkundër situatës me pandeminë e Covid-19, janë kryer 180 operacione të ndryshme. Ai ka theksuar se krejt kjo punë është kryer nga 13 kirurgë torakalë dhe tre specializantë, po ashtu nga 20 infermier/e, por edhe nga stafi tjetër i anesteziologëve me të cilët kanë bashkëpunim të mirë. Sipas tij, është e nevojshme të zgjerohen hapësirat për këtë klinikë në mënyrë që të ketë edhe zgjerim të numrit të shërbimeve që ofrohen në klinikë.

Valbon Krasniqi, drejtor i përgjithshëm i ShSKUK-së, ka theksuar se qëllimi i vizitës është të bashkëbisedojë lidhur me ecurinë e punës dhe avancimin e shërbimeve shëndetësore.



## MSh dhe JICA nënshkruajnë memorandum për grantin për shtretër spitalorë



PRISHTINË, 27 KORRIK (ER) - Në Ministrinë e Shëndetësisë është nënshkruar të martën memorandum i mirëkuptimit për projektin e zhvillimit të kapaciteteve në institucionet spitalore të Republikës së Kosovës që do të financohet nga Agjencia Ndërkombëtare Japoneze për Bashkëpunim (JICA). Ministria e Shëndetësisë,

përkatësisht Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës, do të jetë përfituese e grantit të JICA në vlerë prej 1.3 milionë eurosh për të siguruar shtretër spitalorë për spitalet e përgjithshme dhe klinikat e QKUK-së.

Në emër të Ministrisë së Shëndetësisë marrëveshja është nënshkruar nga sekretari i përgjithshëm, Naim Bardiqi

dhe nga JICA, udhëheqësi i Zyrës për Ballkan, Jiro Takeichi. Sekretari Bardiqi ka shprehur mirënjohjen e thellë për mbështetjen e vazhdueshme të Qeverisë së Japonisë për sektorin shëndetësor dhe se pajisjet që sigurohen përmes grantit do ta ngrehin cilësinë e shërbimeve spitalore dhe lehtësojnë punën e personelit shëndetësor.



## Asfaltohen dymbëdhjetë rrugë në Drenoc të Malishevës

MALISHEVË, 27 KORRIK (ER) - Në kuadër të rregullimit të infrastrukturës rrugore në vendbanimet e komunës së Malishevës dhe në kuadër të realizimit të projekteve kapitale, krahas investimeve në vendbanimet e tjera,

kanë filluar dhe po asfaltohen edhe dymbëdhjetë rrugë në fshatin Drenoc. Për ta parë nga afër asfaltimin e rrugëve, të martën këtë fshat e kanë vizituar nënkryetari i komunës së Malishevës,

Hajdin Berisha dhe drejtori i Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Milazim Morina. Këto rrugë në Drenoc dhe shumë të tjera në fshatrat e komunës së Malishevës janë duke u asfaltuar nga buxheti i komunës.



## Bashkatdhetari dhuron një autoambulancë për komunën e Skenderajt

SKENDERAJ, 27 KORRIK (ER) - Kryetari i Skenderajt, Bekim Jashari, bashkë me drejtorin e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, Ibush Hetemi dhe drejtorin e QKMF-së, Osman Veliu, kanë pranuar autoambulancën e shtatë të siguruar nga bashkatdhetari në Suedi, Blerim Selimi nga fshati Kuqicë, i cili, përveç komunës së Skenderajt, ka dhuruar edhe tri autoambulanca për komunat e tjera në Kosovë. "Për këtë

donacion jetik për qytetarët tanë, falënderoj bashkatdhetarin tonë Blerim Selimi dhe spitalin e qytetit Jonkoping në Suedi". "Si komunë, krahas pranimit të këtyre autoambulancave nga donatorët, jemi në procedurë të blerjes edhe të një autoambulance tjetër si dhe furgonit për nevojat e transportit të pacientëve që janë në hemodializë", ka thënë kryetari Jashari.



## Bulliqi pret në takim kryetarin e Shoqatës së Miqësisë Velbert-Podujevë, flasin për projektet e reja

PODUJEVË, 27 KORRIK (ER) - Kryetari i komunës së Podujevës, Shpejtim Bulliqi, ka pritur të martën në takim kryetarin e Shoqatës së Miqësisë Velbert-Podujevë, Rrahman Islami. Në takim u bisedua për ecurinë e zhvillimit të aktiviteteve të ndërsjella në mes të komunës së Podujevës dhe asaj të Velbertit, programe që burojnë nga marrëveshja e binjakëzimit. Kryetari Bulliqi u shpreh i përkushtuar për vazhdimin e frymës së bashkëpunimit, veçmas për realizimin e programeve që kanë të bëjnë me arsimin, sportin dhe rininë.

Edhe veprimtari Islami u zotua për angazhim për realizimin e projekteve të filluara dhe

zgjerimin e bashkëpunimit edhe në projekte të reja. Në kuadër të këtij partneriteti është duke u zhvilluar një konkurs që ofron bursa për nxënësit

llapjanë të cilët do të kenë mundësi shkollimi në Gjermani, ndërsa në muajt në vazhdim qytetin e Velbertit do ta vizitojnë disa klube sportive nga Podujeva.



## Kryetari i Vushtrrisë merr vaksinën 'AstraZeneca'



VUSHTRRI, 27 KORRIK (ER) - Kryetari i komunës së Vushtrrisë, Xhafer Tahiri, ka marrë të martën dozën e parë të vaksinës 'AstraZeneca' në Qendrën e Vaksinimit në Vushtri. Ai u ka bërë thirrje qytetarëve të Vushtrrisë ta bëjnë të njëjtën gjë.

"Vaksinimi na mbron shëndetin, por edhe ekonominë. Duke hyrë në qendrën e vaksinimit takova qytetarë e miq të Vushtrrisë duke u vaksinuar. I tërë procesi zgjat shumë pak. Falënderoj stafin mjekësor dhe ekipin e vullnetarëve", ka thënë Tahiri.

## Fillon rregullimi i trotuarit në fshatin Novosellë të Kamenicës

KAMENICË, 27 KORRIK - Komuna e Kamenicës ka nënshkruar kontratë për rregullimin e trotuarit në katër fshatra. Fshatrat në të cilët do të zhvillohen punimet nga kjo kontratë janë: Novosellë, Koretin, Topanicë e Petroc. I pari i komunës, Qëndron Kastrati,

pas fillimit të punimeve, u shpreh i lumtur edhe për këtë investim të radhës, i cili do ta lehtësojë qarkullimin e banorëve të këtyre anëve. "Është nënshkruar kontrata për rregullimin e trotuarit në katër fshatra të komunës sonë. Sot punimet nisën në Novosellë, e

së shpejti do të nisin edhe në Koretin, Topanicë e Petroc. Falënderoj kolegët Hasan Rapuçen dhe Mexhid Zylfiun që po monitorojnë nga afër procesin, bashkërisht me drejtorin e DSHPAI, Zotrim Kastratin", është shprehur Kastrati.





## Mbahet takimi i parë i bordit të ri të AGK-së

PRISHTINË, 27 KORRIK (ER) - Është mbajtur të martën për herë të parë takimi i bordit të ri të Asociacionit të Gazetarëve të Kosovës (AGK), ku kanë marrë pjesë 8 nga 9 anëtarët e bordit. Në këtë takim u diskutua për punën, projektet dhe

angazhimin e deritanishëm të organizatës, në një raportim nga ish-kryetarja e bordit, Gentiana Begolli-Pustina. Më pas, anëtarët e bordit diskutuan projekte e ide të reja, të cilat do të shërbejnë për promovimin e mëtutjeshëm të

punës së gazetarëve dhe përmirësimin e ambientit të tyre të punës. Bordi i ri i AGK-së, në krye me gazetarin Xhemajl Rexha, u votuan më 19 korrik, në Kuvendin e AGK-së, ku morën pjesë 320 anëtarë.



# Kurti: Qeveria do t'i mbështetë nismat për zvogëlimin e hendekut në arritjet arsimore të komuniteteve

EPOKA  
ERE

Qendresa RAMA

FUSHË-KOSOVË, 27 KORRIK - "Ekziston një hendek i gjerë në mes të fëmijëve romë, ashkali dhe egjiptianë nga njëra anë dhe

komuniteteve të tjera sa i përket arritjeve në fushën e arsimit. Ky hendek është rritur më shumë gjatë pandemisë, pasi mundësitë e fëmijëve të komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian për ta ndjekur mësimin

online kanë qenë më se të kufizuara", kështu ka thënë kryeministri Albin Kurti në takimin e organizuar me qëllim të mbledhjes së fondeve për ndërtimin e një qendre të re të komunitetit dhe mësimin në

Fushë-Kosovë.

Kurti ka theksuar se qendrat mësimore si kjo kanë kontribuar dhe do të kontribuojnë për zvogëlimin e këtij hendeku, duke mobilizuar potencialin e komunitetit që t'i ndihmojë

pjesëtarët e vet. "Në krah do ta keni edhe Qeverinë e Republikës së Kosovës e cila nuk do të hezitohet t'i mbështesë nismat e tilla", ka thënë kryeministri Kurti. Ai ka thënë se këtë vit për herë të parë MASHTI do të ndajë një fond prej 200 mijë eurosh për organizatat e shoqërisë civile me bazë në komunitet që mbështetin punën e qendrave mësimore, ndërsa vitin tjetër do të bëhen përpjekje që kjo shumë të rritet.

Po këtë vit, në bashkëpunim me partnerët ndërkombëtarë, janë ndarë bursa për 596 nxënës të shkollave të mesme të larta dhe ky program, sipas kryeministrit, do të vazhdojë edhe në të ardhmen. "Në arsimin e lartë publik do të vazhdojmë diskriminimin pozitiv në kuptim të kuotave të rezervuara dhe dhënien e bursave për pjesëtarët e komuniteteve pakicë, por prej këtij viti studimet e larta në sektorin publik do të jenë më të përballeshme, pasi ato do të jenë pa pagesë për të gjithë, pa diskriminuar asnjë njeri", ka thënë kryeministri Kurti.

Projekti për ndërtimin e Qendrës për Komunitetin, i nisur vitin e kaluar nga organizata "The Ideas Partnership", është ndihmuar nga donatorë dhe institucione ndërkombëtare e vendore, por ka mbetur në gjysmë të rrugës për t'u përfunduar.

Qendra ka për qëllim të mbështetë rreth 300 fëmijë në edukim për t'i zgjeruar njohuritë dhe për t'u bërë agjentë të ndryshimeve pozitive për komunitetin e tyre.

## Komandanti i KFOR-it viziton BIK-un

PRISHTINË, 27 KORRIK (ER) - Kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, myftiu Naim ef. Tërnavë, ka pritur të martën në takim komandantin e KFOR-it, gjeneralmajorin Franco Federici. Në këtë takim njohës, Tërnavë i uroi mirëseardhje gjeneralmajorit Federici, duke i dëshiruar punë të mbarë dhe të suksesshme në misionin e tij. Ai më pas e ka njoftuar atë me punët dhe aktivitetet që zhvillon institucioni i

Bashkësisë Islame të Kosovës për mirëqenien e të gjithë qytetarëve pa dallim. Tërnavë ka shprehur mirënjohjen e tij për misionin dhe përkushtimin e forcave paqeruajtëse të KFOR-it, duke shprehur kështu vlerësimin dhe respektin e lartë që kanë qytetarët e Kosovës për ta. Tërnavë ka thënë se BIK-u ka një bashkëpunim shumë të ngushtë me KFOR-in ku kanë organizuar projekte humanitare të përbashkëta në

të mirë të qytetarëve të Kosovës.

Nga ana e tij, gjeneralmajori Franco Federici ka falënderuar myftiun Tërnavë për pritjen dhe nëpërmes tij vlerësoi lart punën dhe angazhimin që ka Bashkësia Islame e Kosovës për mirëqenien e të gjithë qytetarëve, duke vlerësuar kështu harmoninë ndërfaqetare, tolerancën dhe bashkëjetesën ndërmjet të gjithë qytetarëve pa dallim.





# Ministria e Bujqësisë kërkon nga fermerët që mos t'i djegin hamulloret

**EPOKA E RE** Albulena S. MAVRAJ

**PRISHTINË, 27 KORRIK** - Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural ka kërkuar nga fermerët që mos t'i djegin hamulloret pas përfundimit të korrje-shirjeve të grurit. Sipas një njoftimi të kësaj ministrie, me djegien e hamulloreve, pos që shkaktohet ndotje të ambientit, shkaktohen edhe dëme të tjera të shumta, duke shkatërruar mikroflorën dhe mikrofaunën e tokës.

Ministria e Bujqësisë ka dhënë disa udhëzime se si të vepronhet pas korrjes së grurit. "Disa prej udhëzimeve janë që: pas korrjes së grurit në parcelat ku s'ka ujitje, bëni përkufizimin e parcelës duke bërë lëvrimin 2-4 rende në mënyrë që nëse paraqitet zjarri mos të depërtojë edhe në parcelat e tjera. Në parcelat ku nuk ka ujitje pas korrjes së grurit, bëni lëvrimin e cekët dhe në këtë mënyrë kashta e mbetur do të futet në tokë që të kompozohet,

duke ndikuar kështu në përmirësimin e strukturës dhe plleshmërinë e tokës. Djegia e kashtës do të jetë potencial i zjarreve që do ta rrezikojë pasurinë e tjerëve, objektet e banimit, objektet ekonomike, si dhe djegien e pyjeve. Në parcelat ku ka ujitje, menjëherë filloni të bëni lëvrimin dhe mbjelljen e kulturës tjetër në të njëjtën parcelë dhe nëse përcaktoheni të mbillni misrin foragjer me vegetacion të shkurtër (nën 100 ditë), përdoreni dyfishin e farës për mbjellje për ha", theksohet në komunikatën e kësaj ministrie.

Ministria e Bujqësisë ka njoftuar se pas korrjes së grurit, në të njëjtën sipërfaqe mund të mbillen kultura të tjera si misri foragjer me vegetacion të hershëm (që si i gjelbër shfrytëzohet si ushqim për kafshët, por edhe për silazh). "Pastaj perimet si: lakra etj., në të njëjtën kohë do të rritni të hyrat në fermën tuaj. Rëndësia e mbjelljes së kulturës së dytë do të



shërbejë si një qarkullim bimor duke ndikuar në rendimente më

të larta të kulturave që do t'i kultivoni në atë parcelë", është

thënë në komunikatën e Ministrisë së Bujqësisë.

## Miratohet propozimi i qeverisë për anëtarët e bordit të ZRRE-së



**PRISHTINË, 27 KORRIK (ER)** - Pavarësisht prej kritikave nga deputetët e opozitës, anëtarët e Komisionit për Ekonomi me shumicë votash kanë votuar propozimin e qeverisë me emrat për kandidatë për kryesues dhe anëtarë të bordit të Zyrës së Rregullatorit për Energji (ZRRE). Kryetari i Komisionit për Ekonomi, Ferat Shala, ka theksuar se ka shkelje dhe veprime politike për përzgjedhjen e këtyre anëtarëve për këtë bord. "Shkeljet janë tipike politike. Edhe në këtë sektor të

energjisë ka ndërhyrje nga pushteti që udhëhiqet nga LV-ja", ka thënë Shala.

Kritika shprehur edhe deputeti nga AAK-ja, Pal Lekaj, i cili ka theksuar se propozimi i qeverisë është puro politik, të cilin e quajti skandal. Ndërsa anëtarja e këtij komisioni, Mimoza Kusari-Lila, ka mbështetur propozim-vendimin e qeverisë, duke theksuar se kanë eliminuar emrat që kanë qenë politikë.

Kandidat për kryesues të bordit të ZRRE-së, përveç Vehbi Sofiut, është

propozuar edhe Imer Fejzullahu. Për anëtarë të bordit janë propozuar edhe Astrit Saraqini, Gani Buçaj, Arjeta Pajaziti-Qerimi dhe Lutifje Dervishi.

Në këtë mbledhje ka raportuar edhe ministri i Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, Rozeta Hajdari, për nivelin e zbatimit të Ligjit për Shoqëritë Tregtare.

Hajdari ka theksuar se sa i përket këtij ligji kanë avancuar, por që kanë hasur edhe në problematika sikur me rastin e sanksioneve.

## IKShPK, qytetarëve: Shmangeni konsumimin e mishit

**PRISHTINË, 27 KORRIK (ER)** - Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës (IKShPK) u ka bërë thirrje qytetarëve që të kenë kujdes gjatë gatimit, ruajtjes, shpërndarjes dhe konsumimit të ushqimit. Sipas IKShPK, qytetarët shumë herë janë

ballafaquar me helmim të ushqimit, të cilët, për shkak të konsumimit të ushqimit të kontaminuar, kanë përfunduar në spital por, falë përkujdesjes së ekipit të mjekëve, janë jashtë rrezikut për jetë. Me anë të një shkrimi publikuar

në rrjetin social "Facebook", IKShPK ka sugjeruar që qytetarët t'i shmangen konsumimit të mishit, peshkut, suxhukut, ushqimeve që përmbajnë vezë si dhe t'u shmangen ushqimeve që qëndrojnë jashtë frigoriferit për më shumë se dy orë.



## Dogana shënon rekord në të hyra, mblodhi mbi 700 milionë euro

**PRISHTINË, 27 KORRIK (ER)** - Dogana e Kosovës ka mblodhur mbi 700 milionë euro të hyra nga 1 janari deri më 26 korrik. Sipas njoftimit të Doganës, kjo është hera e

parë që tejkalohet shuma prej 700 milionë eurosh për këtë periudhë të vitit dhe paraqet rritje të madhe krahasuar me vitin e shkuar. "Dogana e Kosovës sot ka

tejkuluar 700 milionë euro të hyra dhe kjo paraqet herën e parë që arrihet ky rekord në mbledhjen e të hyrave. Respektivisht, sot janë raportuar 701.2 milionë euro

e që, në krahasim me vitin e kaluar, paraqesin rritje rreth 30 për qind më shumë, pasi vitin e kaluar kishim 543.5 milionë", ka njoftuar Dogana e Kosovës.





WILLIAM BUTLER YEATS

# LËVIZJA DRAMATURGJIKE IRLANDEZE

Ligjërata e Nobelit, 15 dhjetor 1923

Kam zgjedhur temë Lëvizjen dramatike irlandeze ngaqë, kur më kujtohet nderi i madh që më keni dhënë, nuk mund të harroj aq shumë njerëz të njohur e të panjohur. Mbase komitetet angleze nuk do t'jua kishin dërguar kurrë emrin tim po të mos kisha shkruar drama, po të mos kisha shkruar kritika dramash, sikur poezia ime lirike të mos kishte cilësinë e të folurit që luhet në skenë, mbase edhe - ndonëse kjo mund të mos ketë qenë pjesë e mendimit të tyre të qëllimshëm - sikur kjo të mos ishte, në njëfarë mase, simbol i një lëvizjeje. Dëshiroj t'i tregoj Akademisë Mbretërore të Suedisë për mundin, ngadhënjimet dhe shqetësimet e njerëzve që punojnë si unë.

Letërsia moderne e Irlandës dhe, në të vërtetë, i tërë ai trazim mendimesh që gatitej për Luftën Anglo-Irlandeze, zuri fill me rënien e Parnellit nga pushteti më 1891. Një Irlandë e zhgënjyer dhe e hidhur hoqi dorë nga politika parlamentare; një ngjarje mori fill

dhe gara filloi, sa më duket, sa për t'u trazuar nga ngjizja e gjatë e asaj ngjarjeje. Dr. Hajd themeloi Ligën Galike e cila do ta zëvendësojë për vite me radhë argumentin politik me një gramatikë galike, kurse takimet politike me tubimet fshatare, ku këndoheshin këngë dhe tregoheshin rrëfime në gjuhën galike. Në ndërkohë, unë kisha nisur një lëvizje në anglisht, në gjuhën në të cilën Irlanda moderne mendon dhe kryen punët e veta; themelova disa shoqëri në të cilat nëpunësit, punëtorët, njerëz të të gjitha klasave, do të mund të mësonin për ata poetë, romancierë dhe historianë irlandezë që kishin shkruar në anglisht dhe atë letërsi galike që ishte përkthyer në anglisht. Por, masa e madhe e popullit tonë, e mësuar me fjalime të pafundme politike, lexonte pak dhe kështu, që nga fillimi, menduam se duhej të kishin një teatër tonin. Teatrot e Dublinit nuk kishin asgjë për ta që ne do të mund ta quanim tonën.

Ato ishin ndërtesa të zbrazëta të marra me qira nga kompani udhëtuese angleze, kurse ne donim drama irlandeze dhe aktorë irlandezë. Kur mendonim për këto drama, mendonim për çdo gjë që ishte romantike dhe poetike, ngaqë nacionalizmi që kishim ndezur - siç ka ndezur çdo brez në çaste dekurajimi - ishte romantik dhe poetik. Mirëpo, një teatër i tillë u bë i mundur vetëm pasi takova, më 1896, zonjën Gregory, anëtare e një familje të Galway family, që kishte kaluar jetën mes dy shtëpive Galway, shtëpinë ku ishte lindur dhe në shtëpinë ku ishte martuar. Gjithandej saj jetonin fshatarë të cilët tregonin rrëfime në një formë të anglishtes, që kishte një pjesë të madhe të sintaksës së galishtes, një masë të madhe të fjalorit nga anglishtja e tudorëve, por që ne zbuluam shumë ngadalë, në atë të folur të tyre, instrumentin tonë më të fuqishëm dramatik dhe jo para se ajo të zinte të shkruante. Ndonëse dramën e mia ishin shkruar pa

dialekt dhe në 'vargun e bardhë', sikur atë e tërhoqi lëvizja jonë ngaqë tematika e tyre ndryshonte, por fare pak tematika e rrëfimeve fshatareske. Shtëpia e saj është ruajtur nga prania e saj, por shtëpia në të cilën ajo kishte lindur u dogj nga zjarrvënësit para disa muajsh; dhe ka pasur çrregullime të ngjashme në pjesën më të madhe të Irlandës. Një zënkë sa për t'u thënë rreth një pëllëmbë toke mund t'i shndërrojë njerëzit tanë në bisha të egra dhe nëse në luftën e tyre me policinë ndihmëse angleze ishin të pamëshirshëm, ishin edhe këtu: vrasja përgjigjeje me vrasje.

Megjithëkëtë, injoranca dhe dhuna mund ta njohin edhe bukurinë më fisnike. Në Galway kam një kullë të vogël të vjetër dhe kur hip në majë të saj, mund të shoh, jo shumë larg, një fushë gjelbëroshë ku më parë qëndronte kasollja prej kashte e një bukurosheje të njohur të fshatit, mbretëresha e një pronari të vogël tokash. Kam folur me pleq

e plaka, që e mbanin në mend, ndonëse që të gjithë nuk jetojnë më dhe ata më flisnin për të siç kanë folur të vjetrit për Helenën nga muret e Trojës. Në përshkrimin e saj nuk dallonin as burrë as grua. Një plakë, për ririnë e së cilës bashkëfshatarët ruanin një rrëfim skandaloz, më tha për të: "Dridhem në tërë trupin kur mendoj për të". Kishte dhe një grua tjetër plakë në malësinë e afërt, që thoshte: "Dielli dhe hëna nuk rrezatuan kurrë mbi dikë aq të bukur dhe lëkurën e kishte aq të bardhë saqë ngjante me të mavi, kurse në faqe kishte ca të skuqura të vogëlza". Dhe, kishte burra që flisnin për turmat e njerëzve që tuboheshin për të shikuar atë në ditë të bukura dhe për një burrë "i cili kishte gjetur vdekjen duke notuar në një lumë", që të mund ta shikonte. Kishte dhe një këngë të shkruar nga poeti galik Raftery, që i solli asaj aq shumë famë dhe të cilën fshatarët ende e këndojnë, ndonëse nuk janë aq të shumtë ata që e këndojnë, sa ç'kanë qenë kur kam qenë i ri: →



O yll i dritës, o diell i të korrave,  
O flokëzjarrtë, o më e mira e botës,

Je Mary Hynes, ti grua e përhirtë,

Me bukuri trupi dhe shpirti.

Duke sikur bota e lashtë na rrethonte gjithandej me lirinë e përfytyrimit, harenë e rrëfimeve të mira, në fuqinë e burrit dhe bukurinë e gruas dhe e tëra që duhej të bënim ishte ta bënim qytetin të ndihej ashtu siç ndihej fshati, ndonëse shpejt mësuam se qyteti ishte i aftë vetëm për mendime qyteti.

Në fshat, ju jeni të vetëm me dhunën vetjake, me peshën e vetes suaj dhe me tragjedinë e rëndomtë të jetës dhe, nëse keni ndonjë aftësi artistike, ju dëshironi emocione të bukura. Të sigurt se stinët do të jenë gjithmonë të njëjta, nuk do të vrisni mendjen shumë se sa fantastike do të jetë shprehja (1).

Në qytet, ku të gjithë të sulen, ju urreni fqinj tuaj dhe jo veten dhe, nëse nuk doni t'ia nxini jetën atij dhe vetes, mbase edhe nëse nuk do ta vrisni në ndonjë çmendri revolucionare, dikush e ka për detyrë të mësojë për realitetin dhe drejtësinë. Ju do ta urreni atë mësues për ca kohë, duke i quajtur librat dhe dramën e tij të shëmtuara, të shthurura dhe morbide, apo diçka kësajsoj por, në fund të fundit, ju do të pajtohemi me të. Ne u gjetëm në mes të një grindjeje me opinion publik që na detyronte përkundër dëshirës sonë dhe dëshirës së aktorëve që të ishim më realistë, duke përzier dialektin me vargun dhe të folurit e zakonshëm me dialektin.

I kisha thënë zonjës Gregori se nuk shihja gjasë që të gjeja para për një teatër dhe se duhej të hiqja dorë nga ajo shpresë dhe ajo më premtoi se do t'i gjente paratë te miqtë e saj. Fqinji i saj, z. Eduard Martin, i dha paratë për shfaqjet tona të para, kurse aktorët e parë erdhën nga Anglia. Ne aktualisht filluam punën me një kompani të vogël amatorësh irlandezë (2).

Sekush më kishte pyetur në një ligjëratë: "Ku do t'i gjeni aktorët?". Dhe unë thashë: "Unë do të hyj në ndonjë dhomë përplot me njerëz dhe do t'i nxjerr emrat e të gjithë atyre që janë në të një letër dhe do t'i vë të gjithë këta emra në një kapelë dhe do t'i nxjerr dymbëdhjetë të parët". Kam vrarë mendjen shpesh për këtë profeci ngaqë, ndonëse u bë me qëllim për të hutuar dhe ngatërruar atë që pyeti, kjo pothuajse ndodhi pikërisht ashtu. Të dy aktorët tanë më të mirë meshkuj nuk u zgjodhën nga rasti, ç'është e vërteta, ngaqë i pari ishte nga një i punësuar i një gjurmuesi talentesh për skenën dhe tjetri një punëtor i cili kishte udhëtuar nëpër Irlandë me një kompani teatrore që udhëhoqej nga një zezak. Dyshoj nëse kishte qenë në gjendje të mësonte gjë në të, ngaqë metodat e tij ishin të ashpra dhe të zhurmshme, me zezakun që lyente fytyrën në të bardhë sa herë lozte një njeri të bardhë dhe, për të qenë sa më bindës, duke

nxirë ende fytyrën sa herë që lozte një zezak. Nëse një aktor duhej të hapte ndonjë letër në skenë, pa fije dyshimi, ai duhej t'i binte asaj me pëllëmbë dhe, siç kam parë, shumë aktorë të bëjnë në rininë time, përmes një gesticulacioni që ka humbur kuptimin para shumë brezash kur letërthithësja u zëvendësua me rërë. Ndërkaq, gratë i gjetëm nga një shoqëri e vogël politike, që si objektivë kishte edukimin e fëmijëve të të varfërve, që do të thoshte, sipas armiqve të saj, t'u mësonte atyre kateçizmen që fillonte me këtë pyetje: "Cili është burimi i së keqes?", kurse përgjigjja ishte, "Anglia".

Kështu, ata erdhën te ne për arsye patriotike dhe aktruan pikërisht nga cytje të njëjta që i kishte bërë ata të jepnin mësim. Megjithëkëtë, dy prej tyre u dëshmuar si aktorë gjenialë: Miss Allgood dhe Miss "Maire O'Neill". Ato ishin motra, njëra fare e thjeshtë, me mendjen e mprehur nga këngët dhe rrëfimet folklorike, kurse tjetra më e sofistikuar, lirike dhe suptile. Nuk e di çfarë mendimesh kishin me zgjimin e asaj fuqie të re dhe të çuditshme brenda tyre, por ma merr mendja se ato duhet të kenë vuajtur shumë nga varrja e ndërjegjes, nga ndjenja se cytja e vjetër patriotike tashmë ishte tretur dhe se ato i ishin dorëzuar kotësisë dhe ambicies. Megjithëkëtë, unë mendoj se ishte pikërisht ky keqkuptim i parë i vetes së tyre që bëri të mundur gjenialitetin e tyre të veçantë ngaqë sikur ato të kishin ardhur te ne me ambicie teatrore, ato do të kishin imituar ndonjë aktore të njohur angleze dhe do të ishin sfillitur për ndonjë dramë të njohur angleze. Ato as që do të kishin zbuluar gjenialitetin e tyre po të mos kishim qëndruar për një kohë aq të gjatë të padukshëm, porsì zogu në kafaz, duke dhënë shfaqje nëpër salla të vogla, kryesisht nëpër lagje të mbetura dhe periferike. Ne mund të eksperimentonim dhe të prisnim, pa asnjë frikë tjetër, pos keqkuptimit politik. Kishim pak para dhe, në fillim, as që kishim nevojë për më shumë, njëzet e pesë funta që na i jepte zonja Gregori, njëzet funta që jepja unë dhe disa funta të tjera që mblidhnim aty-këtu. Ndërkaq, organizata jonë teatrore ishte absurde, aktorë dhe autorë që rrinin ulur bashkë dhe që vendosnin me votë se cila dramë do të shfaqej dhe kush do të lozte në të. Kalonim nëpër shumë grindje, me javë të tëra debatesh, gjatë të cilave nuk mund të bëhej asnjë shfaqje, para se zonja Gregori dhe John Synge e unë t'i merrnim punët në dorë. Dhe, marrëdhëniet tona me publikun ishin edhe më të trazuar. Një shfaqje na u sulmua dhunshëm nga shtypi patriotik ngaqë ajo përshkruante një grua të martuar fshatare që kishte një të dashur, dhe kur ne botuam tregimin e vjetër popullor aran, mbi të cilin ajo mbështetej, shtypi tha se tregimi ishte vjedhur nga ndonjë autor dekadent i Romës pagane.



Në atë kohë zonja Gregori shkroi dramën e saj të parë. Dramat e mia në vargje nuk ishin mjaft të gjata sa për të mbushur një mbrëmje, kështu që ajo shkruante ndonjë dramë të vogël mbi ndonjë tregim dashurie në dialektin e lagjes së saj. Një fshatar kthehet nga Amerika me njëqind funta në xhep dhe zbulon se e dashura e tij ishte martuar me një fermer të falimentuar. Ai loz me letra me fermerin dhe, duke bërë hile ndaj vetvetes, i jep atij të njëqind funtat. Kompania refuzoi të shfaqte këtë dramë ngaqë, thoshte, ta pranoni kthimin e një emigranti me njëqind funta, do të thoshte ta inkurajonim emigrimin. Ne sillnim dëshmi mbi emigrantë të kthyer me shuma edhe më të mëdha, por na thoshin se kjo i katandiste gjërat edhe më keq. Pastaj, pasi që ky debat i pasosur na molisi të tërëve, zonja Gregori u pajtua të zvogëlonte shumën në njëzet dhe aktorët lëshuan pe. Ajo dramë e vogël e saj ishte sentimentale dhe konvencionale, por drama e saj e ardhshme zbuloi gjenialitetin e saj. Edhe ajo kishte dëshirë për të shërbyer dhe ai gjenialitet do t'i ishte dukur asaj i mrekullueshëm. Ajo ishte në moshë të mesme dhe nuk kishte shkruar gjë pos një vëllimi kujtimesh politike dhe nuk kishte fare interesim për teatrin.

Askush që lexon sot të shtatë dramën e saj të shkruar mund të kuptojë se pse njëra prej tyre, që tani i takon klasikes irlandeze, Lindja e hënës, nuk mund të shfaqej për dy vjet me radhë për shkak të armiqësisë politike. Një polic zbulon një të burgosur fenian të arratisur dhe e lë të lirë ngaqë i burgosuri me disa këngë të vjetra kishte ngjallur patriotizmin pothuajse të harruar nga rinia e tij. Aktorët nuk donin ta shfaqnin ngaqë thoshin se ishte një akt jopatriotik të pranosh se një polic ishte i aftë për


patriotizëm. Një lider i njohur nga turma, më shkruante, "si mund të pritët që populli i Dublinit të luftojë kundër policisë, nëse i shikon ata si të aftë për patriotizëm?". Kur, më në fund, u shfaq, drama u pranua me entuziazëm, por vetëm sa për të na futur në telashe të tjera. Gazeta kryesore unioniste e Dublinit ngriti akuzën për gënjeshtëri ndaj forcave të Madhërisë së Tij, mbretit, kurse Kështjella e Dublinit, që ishte qendër e Qeverisë në Irlandë, na i hoqi të gjitha privilegjet që kishim si dhe të gjitha teatrot e tjera të Dublinit të blerjes së uniformave të vjetra të policisë për qëllime skenografike. Si Kështjella, ashtu dhe shtypi, e dinin se policia shpesh i linte të burgosurit politikë të lirë, por "kjo vetëm i katandisi punët edhe më keq". Çdo parti politike kishte të njëjtën dëshirë për të qenë zëvendësimit i jetës, që kurrë nuk bën dy herë të njëjtën gjë, një grumbull parimesh dhe pohimesh në të cilat mbështeten (3). Për më tepër, as ortodoksia fetare nuk na donte më shumë se ajo politike. Drama ime Kontesha Katlinë u sulmua nga Kardinali Logue si një dramë heretike dhe kur shkrova se ne donim të shfaqnin "kryevepra të huaja", një gazetë nacionaliste deklaroi se "një kryevepër e huaj është punë shumë me rrezik". Sallat e vogla, në të cilat i jepnim shfaqjet, zinin deri në dyqind vetë dhe publiku ynë shpesh nuk përbëhej nga më shumë se njëzet a tridhjetë vetë. Ne jepnim shfaqje dy apo tri herë në muaj dhe gjatë periudhave të grindjeve as aq. Mirëpo, kryeartikujt nuk mungonin, njiheshim që nga fillimi si rezik publik. Dy ngjarje na sollën fitoren. Një mike na dha një teatër dhe ne gjetëm një njeri të çuditshëm prej gjeniu, John Synge. Pas një artikulli jashtëzakonisht të zemëruar kisha

dalë para perdes dhe po u bëja thirrje qindra shikuesve që të na përkrahnin. Me të zbritur nga skena, një mike e vjetër, Mis Horniman, prej së cilës prisja një kontribut prej njëzet funtesh, më tha: "Unë do të ta gjej një teatër". Ajo e gjeti dhe bëri ndryshime në të për t'ua përshtatur nevojave tona, ajo që sot është Abbey Theater, në Dublin, dhe na dha edhe një ndihmesë të vogël për disa vjet.

John Syngein e kisha takuar në Paris më 1896. Dikush kishte folur, "është një irlandez që jeton në katin e sipërm të hotelit tënd dhe unë do të të njoftoj me të". Unë isha shumë i skamur, por ai ishte edhe më i skamur se unë. Ai i takonte një familje shumë të vjetër irlandeze dhe, ndonëse ishte një burrë i thjeshtë dhe shumë i përzemërt, ai e dinte këtë dhe ishte kryelartë dhe i vetmuar. Pothuajse me asgjë më shumë se të mbante frymën dhe gati gjithmonë i uritur, ai ishte sorollatur nëpër Evropë duke udhëtuar në klasë të tretë dhe herë këmbë, duke i rënë violinës gjatë rrugës apo nëpër kasolle. Ky ishte njeriu që na duhej, ngaqë ai ishte i vetmi njeri që kisha njohur që ishte i paaftë për mendim politik apo për ndonjë qëllim humanitar. Ai ishte në gjendje të ecte tërë ditën në rrugë me ndonjë varfanjak pa asnjë dëshirë për t'i bërë ndonjë të mirë, apo për asnjë arsye tjetër, pos se i pëlqente. Ai ishte njeri për Irlandën, ndonëse më shumë me ndikimin e tij te dramaturgët e tjerë sesa nga ndikimi i tij i drejtpërdrejtë, ashtu siç bëri Robert Burns për Skotlandën. Kur Skotlanda e mendonte veten të zymtë dhe fetare, Hyjnia i ktheu asaj spontanitetin imagjativ duke ngritur Robert Burns për t'i thurur lavdi pijes dhe djallit. Megjithëkëtë, unë nuk isha i vetëdijshëm se çfarë do të vinte më pastaj kur e këshillova John Syngein të vinte te një ishull i egër pranë bregut të Galwayit dhe ta studionte jetën e tij ngaqë ajo jetë "nuk është shprehur kurrë në letërsi". Ai kishte mësuar galishten në kolegji dhe unë ia thashë këtë, siç do t'i kisha thënë çdo të riu që kishte mësuar galishten dhe që donte të shkruante. Kur ai gjeti atë ishull të egër, ai u bë i lumtur për herë të parë, duke u arratisur kështu, siç thoshte, "nga pavlefshmëria e të pasurve dhe pisllekë i të varfërve". Ishte shëndetlig. Ai s'u bënte dot ballë vështirësive të ishullit për një kohë të gjatë, por ai vazhdonte të udhëtonte midis atij vendi dhe Dublinit.

As vetë Bërnsi (Burns) nuk do të mund të kishte tronditur më shumë tubimet e klerikëve skocezë nga ç'i tronditi ai aktorët tanë. Disa nga gratë iu qasnin dhe e lusnin të shkruante ndonjë dramë mbi kryengritjen e viteve '98 duke i vënë në pah se një dramë me temë të tillë patriotike do të ishte sukses i madh. Ai erdhi pas dy javësh me një skenar në të cilin ai kishte punuar në mënyrën e vet të mundimshme. Dy gra





gjejnë strehë në një shpellë, njëra protestante dhe tjetra katolike dhe futen në një diskutim të ngatërruar mbi meritat e feve të tyre gjegjëse. Gruaja katolike akuzon Henrin VIII dhe Mbretëreshën Elizabeta, kurse gruaja protestante fajëson inkuizionin dhe Papën. Ato debatojnë me zë të ulët ngaqë njëra ka frikë se mos zihet nga kryengritësit dhe tjetra nga ushtarët lojalistë. Por, më në fund, si protestantja ashtu dhe katolikja pohojnë se do të parapëlqenin çdo fat tjetër pos të qëndrojnë në një shoqëri të tillë dhe secila ikën jashtë. Drama as nuk u shkrua dhe as nuk u shfaq dhe unë as atëherë as më vonë nuk mora vesh nëse Synge e kuptonte vetë tronditjen që po krijonte. Ai assesi të parashihte belanë e madhe në të cilën po na fuste ne të gjithëve drama e tij më e madhe.

Kur zbarkova nga një lundëz peshkimi në mes të ishullit Aran, disa muaj para se të takoja Syngein, një grup i vogël banorësh të ishullit, të cilët ishin tubuar për ta parë arritjen e një të huaji, më sollën deri te "plaku më i vjetër i ishullit". Ai më tha vetëm dy fjali, duke i shqiptuar ato shumë ngadalë, "nëse një zotëri ka bërë një krim, ne do ta fshehim. Ishte një zotëri që kishte vrarë të atin dhe unë e mbajta në shtëpi për tre muaj derisa iku në Amerikë". Kishte një dramë që bazohej në tregimin e plakut, që Synge e kishte sjellë me vete. Një i ri arrin në një shtëpi të vogël publike dhe i thotë bijës së pijetarit se ai kishte vrarë të atin. Ai ia thotë këtë në atë mënyrë saqë ai fiton simpatinë e saj dhe sa herë që e përsërit rrëfimin, me zmadhime dhe ndajshime të reja, ai fiton simpatinë e njerit apo tjetrit, ngaqë është zakoni i fshatarit për të qenë kundër ligjit. Fshatari mendon se sa më i tmerrshëm që të jetë krimi, aq më i madh do të ketë qenë provokimi. Vetë djaloshi, nën dalldinë e tregimit të vet, ndihet i gëzuar, përplot energji dhe fat. Ai prosperon në dashuri dhe zë vendin e parë në

garat lokale dhe më pas falimenton tavolinën e ruletit. Pastaj, ia beh i ati, me kokën e lidhur, por i gjallë, kurse njerëzit i kthehen mashtruesit. Për ta kthyer vlerësimin e tyre ai merr një lopatë për të vrarë vërtet të atin, por i tmerruar nga ajo që tingëllonte aq mirë në rrëfim, ata e lidhin atë dhe e dorëzojnë në polici. I ati e liron dhe atë e bir largohen së bashku, i biri i ndjekur nga imagjinata e tij duke shpallur se që këtej ai do të bëhet zotëri. Piktore, poetike, fantastike, një kryevepër e stilit dhe muzikës, vepër supreme e teatrit tonë dialektor, kjo ngriti masën në zemëratë. E shfaqim nën mbrojtjen e policisë, me shtatëdhjetë policë në teatër në mbrëmje dhe, pesë qind të tjerë, thoshin disa gazeta, që mbanin rendin jashtë. Nuk është luajtur kurrë për herë të parë para një publiku irlandez që nuk ka hedhur diçka mbi aktorët. Në Nju-Jork, një tortë me rrush të tharë dhe një orë u hodh, me pronarin e orës që e kërkonte t'i kthehej ajo te dera e skenës më vonë. Megjithëkëtë, publiku i Dublinit që nga atëherë ka pranuar dramën. Ka kuptuar, ma thotë mendja, se secili mbi skenë është disi i dashur dhe i shoqërueshëm dhe se Synge kishte përshkruar, ndonëse përmes një simbolizmi të ekzagjeruar, një realitet që ai e donte pikërisht ngaqë ai donte çdo realitet. Larg nga të qenit, siç e mendonin ata, politikan që punonte për interesat e Anglisë, ai ishte politikan aq i vogël saqë bota vetëm sa e dëfrente atë dhe prekte keqardhjen e tij. Megjithëkëtë, kur Synge vdiq, më 1910, mendimi pothuajse nuk kishte ndryshuar, ne loznim nëpër teatro gati të zbrazët dhe vazhdonim të ishim të sulmuar në shtyp. Fitorja jonë u arrit nga ata që kishim mësuar nga ai guximin dhe sinqeritetin, por që i takonin një shkollë tjetër. Vepra e Syngeit, vepra e zonzës Gregori dhe vepra ime Katlina në Houlihan dhe Ora prej xhami, në formën e saj në prozë, janë tipike

për ambicien tonë të parë. Ato sjellin imagjinatën dhe të folurit e vendit, tërë atë traditë poetike që rrodhi nga mesjeta deri te njerëzit e qytetit. Ata që kishin mësuar nga Synge shpesh kishin fare pak njohuri për vendin dhe gjithmonë fare pak interesim për dialektin e tij. Dramat e tyre janë shpesh sulme ndaj keqbërjeve të thjeshta, mitosjes së ndonjë mjeku dispenserik, orvatjet e ndonjë politikani vendor për të mbetur mik me të gjitha partitë. Në të vërtetë, ministrat e rinj dhe politikanët partiakë të Shtetit të Lirë, mendoj unë, ishin arsimuar nga dramat tona. Por, prapë ka dhe shumë komedi që nuk janë satira politike, ndonëse ato merren me jetën e njerëzve të qytetit të ngarkuar me politikë. Prej tyre, më të njohurat janë ato të z. Lennox Robinson; Djaloshi kryebardhë i tij është lozur në Angli dhe në Amerikë. Së voni, duket sikur kësaj shkollë po i vinte fundi ngaqë përmbajtjet e vjetra përsëriten me variacione të vogla, kurse karakteret janë bërë mekanike. Ende është herët të themi se çfarë do të na dalë nga melodrama dhe tragjedia e katër vjetëve të fundit, por nëse do të jemi në gjendje t'i paguajmë aktorët tanë dhe ta mbajmë teatrin të hapur, diçka do të dalë (4). Jemi zhjytur në borxhe, pasi që kemi dalë nga lufta dhe lufta civile dhe publiku rrallohen kur ka të shtëna në rrugë. Po, prapëseprapë, kemi mbetur gjallë aq mirë saqë unë besoj në fat dhe mendoj se kam të drejtë të them se mund ta përfundoj ligjëratën time në mes apo mbase në fillim të rrëfimit. Por, gjithsesi, kam folur mjaft për t'u bërë që ta kuptoni se pse, kur mora nga duart e Mbretit tuaj nderin e madh që më ka ndarë Akademia juaj, përfytyroja sikur fantazma e një të riu të më rrinte në njërin anë dhe në tjetrin një grua e gjallë në moshën e saj jetike të pleqërisë. Kam parë pak gjëra, në javët e fundit, që nuk do të ishin të paharrueshme dhe ngacmuese për Syngein dhe për zonzën Gregori, ngaqë Suedia ka arritur shumë më shumë nga ç'do të mund të shpresonim ne për vendin tonë. E kam fjalën, ndoshta, mbi të gjithë për atë spektakël të shkëlqyer të oborrit tuaj, një familje e dashur dhe e aftë që ka tubuar jo vetëm rangun, por edhe mendjen e vendit tuaj. Asnjë spektakël i ngjashëm në Irlandë nuk do ta tregonte disiplinën dhe shijen e saj, ndonëse do të mund të përmbushte një nevojë të racës që asnjë institucion i krijuar nga demokracia angleze apo amerikane nuk është në gjendje ta përmbushë.

Shënime:

\* Yeats ishte i mendimit se ligjëratat e tij ishte fshirë nga kujtesa. Prandaj, na duket me vend që t'i inkorporojmë këtu disa plotësime që i bëri ai në një version të botuar në The Bounty of Sweden (The Cuala Press, Dublin, 1925).

1. Isha në shtëpinë time në

Galway gjatë muajve të parë të luftës civile, me urat e hedhura në ajër dhe rrugët e bllokuara me gurë e drurë. Në javën e parë nuk kishte gazeta dhe as lajme të besueshme, ne nuk dinim se kush kishte fituar dhe kush kishte humbur dhe, edhe pas daljes së gazetave, nuk dinte kush se çfarë po ndodhte në anën tjetër të kodrës apo te vija e drunjtë. Makina "Ford" kalonin pranë shtëpisë herë pas herë me arkivole të vendosura mbi apo mes ulësesh dhe, nganjëherë gjatë natës, dëgjonim ndonjë shpërthim dhe pastaj gjatë ditës shihnim tymin që ishte shkaktuar nga djegia e shtëpisë së fqinjit. Njerëzit dukej të kishin kaluar jetën asisoj për shekuj të tërë të trazuar. Ndiemim një dëshirë mbizotëruese për të mos shfaqur dëshpërimin apo hidhërimin, për të mos humbur tërë ndjenjën e bukurisë së natyrës. Një gargull kishte ndërtuar një vrimë pranë dritares sime dhe unë shkrova këto vargje i frymëzuar nga ndjenja e çastit:

Bletët ngrijnë nëpër plasa  
Ndërtesash të vjetra dhe aty  
Zogjtë nëna sjellin larva e  
ushqim.

Muri im nuk mban, ju bletë  
mjalti

Ejani në shtëpinë boshe të  
gargullit.

Rimë mbyllur brenda dhe  
çelësi është kyçur

Në pasigurinë tonë, diku

Një njeri është vrarë, një shtëpi  
është djegur,

Po s'ka dëshmi për t'u parë:

Ejani në shtëpinë boshe të  
gargullit.

Ky është vetëm fillimi, por vazhdon me të njëjtin disponim. Aktualisht ka ndodhur një gjë e çuditshme; zura ta ndieja erën e mjaltit edhe aty ku nuk kishte mjaltë, në të dalë të ndonjë shtegu guror apo pranë ndonjë kthese të rrahur nga erërat dhe vinte gjithmonë me mendime të caktuara. Me t'u kthyer në Dublin ndieja zemërim me njerëzit, që ziheshin për çdo gjë apo që ishin të padurueshëm për t'i ditur faktet e sakta. Ata kishin një disponim që përbën dramën realiste.

2. Shfaqjet tona të para i pagoi z. Edward Martyn, një pronar tokash në Galway, që kishte një shtëpi pjesërisht të shekullit katërmëdhjetë dhe pjesërisht të stilit gotik, që ishte aq i dëshiruar nga familjet katolike irlandeze. Ai kishte një sallë të madhe të zburuar me motive të përsëritura të dekoruesit të zymtë Crace, ku ai vinte palestrinën mbi një organ dhe studime portretesh të poetëve mbi xham të ngjyrosur dosido, ku ai lexonte Ibsenin dhe Etërit e kishës dhe asgjë tjetër. Një burrë me sens miqësor dhe inteligjent, me forcë synimi dhe sjellje sharmante, ai druhej nga gratë pors një murg mesjetar dhe midis tij dhe të gjithë përvojës dilte një tmerr i papërshkrueshëm, "nëse bëj këtë apo atë gjë, apo nëse lexoj

këtë apo atë libër, mund ta humbas shpirtin". Kontesha Katlinë dhe një dramë e shkruar nga vetë ai ishin shfaqjet tona të para. Heroina e dramës sime, pasi që ia kishte shitur shpirtin djallit, e kthen atë prapë, ngaqë 'Zoti sheh vetëm motivin dhe jo veprën', kurse motivi i saj është që të shpëtojë të uriturit nga shitja e shpirtit të tyre për hir të trupit. Pasi i bëmë të gjitha shpalljet, Martin na e hoqi mbështetjen, ngaqë atij i kishte thënë një priift se drama ishte heretike. I gjeta dy priiftërinj që t'i pohonin se kjo nuk ishte e vërtetë dhe ai mbeti i kënaqur, ngaqë ne kemi ide demokratike. Ai përfundimisht u tërhoq. Megjithëkëtë, pas disa muajsh, pasi që shihte rrezik për shpirtin e tij në të ardhmen, ai vdiq dhe bashkë me të vdiq familja që i përkiste shekullit të dymbëdhjetë. Një burrë i palumtur, i pafëmijë, i mundimshëm, i paplotësuar, një burrë tipik i një Irlandë që po vdes.

3. Josef Strzygowski, në librin e tij Origjina e artit të kishës së krishterë (një përkthim i një sërë ligjëratash, të mbajtura në Upsala më 1919), thotë se arti "lulëzon më pak në oborre se kudo tjetër në botë ngaqë në selinë e pushtetit çdo gjë i është nënshtruar politikës; forcat që janë të gatshme të pranojnë këtë fakt janë gjithnjë të mirëpritura, ato që nuk janë të gatshme duhet ose të emigrojnë apo të mbesin sipër". Rreziku për artin dhe letërsinë vjen sot nga tirania dhe nga bindjet e shoqërive revolucionare dhe formave të propagandës politike dhe fetare. Bindja e ka korruptuar shumë letërsinë moderne angleze dhe gjatë njëzet e pesë vjetëve që na çuan te revolucioni ynë kombëtar, tirania shteri pjesën më të madhe të energjisë të dramaturgëve dhe poetëve irlandezë. Ata ishin të shtrënguar të jetonin prore me sytë katër për ta mbrojtur krijimtarinë e tyre dhe, sa më e natyrshme që ishte krijimtaria, aq më e vështirë ishte mbrojtja.

4. Që nga ligjëratat ime ne kemi prodhuar Junon dhe Paycock nga O'Casey, sukcesi më i madh që kemi pasur me vite. Në këtë dramë, që nxjerr karakteret dhe skenat nga lagjet e varfra të Dublinit, një mendje, e ngjashme me atë të Dostojevskit, vështro mbi dhunën dhe tragjedinë e luftës civile. Ka vrasje, varfërim të papritur dhe humor të tërë dehurve dhe filozofi të bjerrakohësve. Ka pak gjë tjetër pos temës së stërpërdorur të ngjashënjimit dhe, mbase, një a dy fraza të humorit mekanik, për të parë nëse autori i saj ka mbaruar arsimimin e tij artistik. Ai është një murator tjegullash, që është nxjerrë nga ushtarët anglezë për t'u ekzekutuar për një tjetër, por që ka ikur në një çast konfuzioni. Ai e di në tërësi jetën të cilën e përshkruan.

(Marrë nga numri i 11-të i revistës "Akademia". Përktheu: Avni Spahiu)



**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON  
Envert  
Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE  
'BUJQËSIA'**  
TEL: 045/82 82 82

## Fetahu: Fillimi i suksesshëm i një rrugëtimi të gjatë

Kosova debutoi suksesshëm në arenën ndërkombëtare, duke fituar edhe medalje. Kryetari i FBK-së, Arben Fetahu është optimist se vashat e Kosovës do të kenë të ardhme të ndritur dhe në të ardhmen do të sjellin suksese me të mëdha. “Debutuan. Sollën medalje. Emocione. Adrenalinë. Krenari. Basketbollistet e Kosovës filluan me medalje të bronzte paraqitjen në arenën ndërkombëtare. Ky është suksesi i parë i një rrugëtimi që pritet të jetë i gjatë dhe besojmë me shumë suksese. Vashat e Kosovës treguan si duhet luajtur për fanellë dhe si duhet luftuar. Ato treguan se ishte një vendim i drejtë paraqitja në garat ndërkombëtare”, ka thënë Fetahu



fund”, ka shtuar ai. Numri një i Federatës së Basketbollit të Kosovës ka falënderuar basketbollistet për paraqitje dhe ka premtuar se do të vazhdojë t'i përkrah në vazhdimësi me gjithë potencialin që posedon federata. “Jo pak emocione solli debutimi ndaj Qipros. Një fund dramatik, që u vendos me një tre pikësh. Solli debutimin e ëndrrave. Një fitore ku u gëzuan i madh e i vogël. Fitorja ndaj Maltës bëri që vashat e Kosovës të kenë në qafë medaljen e bronzte. Një medalje në debutim. Ky është fillimi i suksesshëm i një rrugëtimi të gjatë e shpresojmë me plot suksese. Në emër timin personal, Bordit të Federatës së Basketbollit të Kosovës (FBK) dhe të gjithë punëtorëve në FBK, ju garantojmë se përkrahja nuk do të mungojë asnjëherë ndaj jush. Trajtimi do të jetë në nivelin më të lartë. E gjithë puna është bërë që ju sot të keni mundësi të përfaqësoni vendin në garat ndërkombëtare. Gëzofshim së bashku shumë suksese”, ka përfunduar Fetahu.

### “Epoka e re”

**PRISHTINË, 27 KORRIK** - Përfaqësuesja e Kosovës në basketboll e fituan medaljen e bronzte paraqitjen në paraqitjen e parë në arenën ndërkombëtare. Kryetari i Federatës së Basketbollit të Kosovës, Arben Fetahu ka thënë se ky është suksesi i parë në rrugëtimin që pritet të jetë i gjatë dhe me shumë suksese.

“Debutuan. Sollën medalje. Emocione. Adrenalinë. Krenari. Basketbollistet e Kosovës filluan me medalje të bronzte paraqitjen në arenën ndërkombëtare. Ky është suksesi i parë i një rrugëtimi që pritet të jetë i gjatë dhe besojmë me shumë suksese. Vashat e Kosovës treguan si duhet luajtur për fanellë dhe si duhet luftuar. Ato treguan se ishte një vendim i drejtë paraqitja në garat ndërkombëtare”, ka thënë

Fetahu, i cili lavdëroi basketbollistet nga kapitenia Arbnore Përquku e deri te 16 vjeçarja Astera Tuhina për maksimumin e dhënë në FIBA Kampionatin Evropian për Shtete të Vogla. Kosova ka një ekip të kombinuar me lojtare me përvojë dhe të talentuara dhe preton shumë për të ardhmen. “Kosova ka pasur shumë basketbolliste të jashtëzakonshme, por nuk kishin mundësi të bartin fanellën e

Përfaqësues, padrejtësisht pasi nuk ishim të pranuar në FIBA. Shumë basketbolliste e mbyllën karrierën me një vetëm peng. Shumë basketbolliste nuk e realizuan ëndrrën e vetëm në karrierë. Shumë punuan e jetuan për këtë ditë. Kjo gjeneratë do të mbetet në histori si debutuese në garat ndërkombëtare. Gjeneratë që përjetuan emocione që nuk i kishin përjetuar të tjerët Vashat e Kosovës e veshën me krenari fanellën dhe e mbrojtën deri në

## Kondirolli theu rekordin personal, por nuk kualifikohet tutje në ‘Tokyo 2020’

**PRISHTINË, 27 KORRIK** - Olt Kondirolli ka përfunduar garimin në not 100 metra stil i lirë. Ai garoi në grupin e parë dhe përfundoi në vendin e dytë me kohë 54:33. Ai arriti ta thyente rekordin personal por, fatkeqësisht, nuk ia doli të kualifikohet në gjysmëfinale. Bateritë e tjera patën garues me kohë më të shpejtë dhe kështu notarit nga Kosova iu pamundësua kualifikimi në mesin e 16 notarëve më të mirë. Nga 70 garues sa morën pjesë, Olt Kondirolli u rendit i 64-ti, pasi që bateria e tij ishte më e ngadalshme. Kondirolli ishte garuesi i tetë i Kosovës që garoi në Lojërat Olimpikë “Tokyo 2020”. Pas tij, në ditët në vijim do të garojnë edhe Musa Hajdari, Loriana Kuka dhe Egzon Shala.



## Donjeta Sadiku eliminohet nga Lojërat Olimpikë

**PRISHTINË, 27 KORRIK** - Boksierja Donjeta Sadiku garoi të martën në Lojërat Olimpikë “Tokyo 2020”. Sadiku pësoi humbje nga Caroline Dupuis e Britanisë së Madhe, kategoria 57 - 60 kg. Dupuis është kampione olimpikë për të reja dhe finaliste e turneut kualifikues evropian për “Tokio

2020”. Humbja e boksieres tonë do ta bëjë më të fortë për garat e ardhshme. Të pranishëm për ta përkrahur Donjetën ishin edhe drejtuesit e KOK-ut në krye me presidentin Ismet Krasniqi. 22-vjeçarja ishte një prej pesë garueseve nga Kosova që morën pjesë në Olimpiadë përmes ftesës.

## Hajdari vijon përgatitjet për garën e 31 korrikut

Prishtinë, 27 korrik - Atleti i Kosovës, Musa Hajdari, prej dy ditësh ka nisur t'i vijojë përgatitjet në Tokio të Japonisë, para garës

që e pret më 31 korrik në disiplinën 800 metra. Atleti i Kosovës bashkë me trajnerin Zijadin Kryeziu dhe me anëtarin e bordit

Ekzekutiv të KOK-ut, Halil Sylejmani, njëherësh kryetar i Federatës së Atletikës së Kosovës, kanë arritur të dielën mbrëma

në Fshatin Olimpik. Hajdari të martën u përgatit me boshnjakun Amel Tuka, nënkampion bote.



## Isufi: Ballkani në dy vjetët e shkuar ka qenë kampion moral në Superligë

**SUHAREKË, 27 KORRIK** - Trajneri i njohur nga Kosova, Bekim Isufi, ka shprehur kënaqësi me gjendjen të cilën e ka gjetur klubin si për organizimin ashtu edhe për nivelin e përgatitjes të lojtarëve. Ai theksoi se ky grup i lojtarëve të Ballkanit është i

gatshëm, është i pjekur dhe ka mësuar prej gabimeve. "Ky grup i lojtarëve edhe në dy vjetët e kaluar ka treguar se ka qenë kampion moral i Superligës së Kosovës, ndoshta disa faktorë apo edhe përvoja ka bërë që mos të arrihet, apo

edhe detajet e vogla, por mendoj se ky grup i lojtarëve është i gatshëm, është i pjekur, ka mësuar prej gabimeve dhe do të përpqemi që gjatë rrugës sa më pak të bëjmë gabime dhe të shohim prej ndeshjes në ndeshje, prej ditës në ditë në

stërvitje dhe prej ndeshjes në ndeshje në kampionat. Mendoj se do të shikojmë edhe çka na duhet dhe cilat janë përforsimet që të kompletohet dhe të jemi sa më të qetë në fillim të kampionatit", ka deklaruar Isufi.



## Kosova befasohet nga Mozambiku

**PRISHTINË, 27 KORRIK** - Përfaqësuesja e Mozambikut e ka befasuar Përfaqësuesen e Kosovës në futsall, duke e mundur me rezultat 2:1 në ndeshjen e fundit të Grupit A në kuadër të turneut kontinental të futsallit që po mbahet në Tajlandë. Pas humbjes nga Uzbekistani dhe barazimit me Tajlandën, "dardanët" vlerësoheshin favoritë për fitore përballë Mozambikut, i cili në dy ndeshjet e para kishte pësuar humbje, mirëpo në fushën e lojës ndodhi e kundërta. Paraqitja e zbehtë e lojtarëve të Kosovës i dha mundësi Mozambikut që ta mbyllë pjesën e parë me dy gola epërsi. Fillimisht shifrat i zhbllkoi Idelson Francisco në minutën e 4-t, ndërsa epërsinë në 2:0 e shtoi Mario Jona në sekondat e fundit të 20 minutave të parë. Disavantazhi i papritur i dy golave bëri që nervozizmi të "dardanët" të rritej edhe më shumë në pjesën e dytë dhe, si rrjedhojë, nuk u arrit që të bëhej përmbysja e rezultatit, përveç ngushtimit të disavantazhit me golin e Jeton Rukovcit në sekondat e fundit të ndeshjes. Paraqitja e sotme e ka lënë tejet të zhgënjyer edhe përzgjedhësin Arben Simitçiu, i cili vlerësoi se lojtarët e tij në këtë takim e nënçmuan kundërshtarin. "Jam shumë i



zhgënjyer me rezultatin e sotëm sepse Mozambiku nuk është kundërshtar i cili mundet në rrethana normale të na mundë. Sot nuk kemi qenë vetvetja sepse kemi hyrë në lojë të shpërqendruar dhe me nënçmim të kualitetit të kundërshtarit. Pavarësisht prej të gjitha udhëzimeve që ua dhashë lojtarëve para lojës, pikërisht për të pasur kujdes, ne nuk e nisëm lojën si duhej dhe ashtu na shkoi deri në fund! Sidoqoftë, kjo ndeshje më shërbeu shumë si një test për ekipin

që ta shoh paraqitjen e tij në tri lojë brenda tri ditëve si dhe në kushte ekstreme fizike", ka thënë Simitçiu. "Ashtu siç i lavdërova djemtë për paraqitjen e shkëlqyeshme në dy ndeshjet e para kundër dy kundërshtarëve shumë më të fortë, sot do t'i qortoj për paraqitje të dobët. Nuk dua fare të justifikohem për këtë rezultat as për lojtarët e lënduar dhe ata me kartonë që nuk kishin të drejtë loje. Thjesht, sot duhej të kishim fituar", ka shtuar Simitçiu.

## Drejtori ekzekutiv i FIBA Evropës përgëzon drejtuesit e FBK-së për suksesin në Qipro

**PRISHTINË, 27 KORRIK** - Kosova A (F) arriti ta fitojë medaljen e bronzë në FIBA Kampionatin Evropian për Shtete të Vogla në debutimin në arenën ndërkombëtare. Kamil Novak, drejtori ekzekutiv i FIBA Evropës, me anë të një letre iu ka drejtuar Arben Fetahut, kryetar i Federatës së Basketbollit të Kosovës (FBK) dhe sekretares së përgjithshme, Elvira Dushku, duke i përgëzuar për suksesin në Qipro dhe duke përgëzuar punën e Federatës që ka bërë ndër vite në basketbollin femëror. "Në emër të FIBA Europe, unë do të doja ta përgëzoja Kombëtaren e Femrave për fitimin e medaljes së bronzë në FIBA Kampionatin Evropian të Femrave për Shtetet e Vogla. Rezultatet dhe ecuria e ekipit tuaj gjatë kampionatit në Nikosia ishin kulmi i të gjitha përpjekjeve dhe investimeve të Federatës suaj në



basketbollin femëror gjatë viteve të kaluara. Edhe një herë, urime dhe uroj

fat për sezonin e ardhshëm!", thuhet në letrën e dërguar nga Novak.

### SHKURT

#### Atalanta transferon Pezzellan

Skuadra e Atalantës e ka zyrtarizuar transferimin e Giuseppe Pezzellas. Ish-mbrojtësi i Parmës do ta vazhdojë karrierën në Bergamo, ku do ta veshë fanellën e "La Deas". Pezzella shihet si një nga mbrojtësit më të talentuar pas paraqitjeve të mira të tij me fanellën e Parmës, e cila tani garon në Serinë B. Atalanta e ka zyrtarizuar transferimin e tij përmes llogarisë zyrtare në "Twitter".

#### Jovetiç përforcon Herthan

Sulmuesi malazez Stevan Jovetiç ka mbyllur bashkëpunimin me Monacon dhe tani është gati për një aventurë në Bundesligë. Sipas mediave gjermane, futbollisti 32-vjeçar ka arritur marrëveshje me Herthën e Berlinit për një kontratë trevjeçare dhe zyrtarizimi është vetëm çështje orësh. Sulmuesi malazez ka luajtur më herët në kampionatin italian, anglez, spanjoll dhe francez, ndërsa me kalimin në Bundesligë kompletton 45-shen e ligave kryesore evropiane.

#### Tolisso infektohet me Covid

Koronavirusi kthehet te klubet dhe gjatë ditëve të fundit janë njoftuar infektimet e para në klubet e arenës së madhe të futbollit. Të martën Bayern Munchen konfirmoi për një lojtar të infektuar dhe bëhet fjalë për Corentin Tolisso. Mesfushori i Francës është kthyer prej ditësh në stërvitje, por tashmë i duhet të ndalet. Gjendja e tij shëndetësore nuk shfaqet shqetësuese, por kjo nuk e shmang izolimin deri në shërim të plotë të tij, për ta shmangur përhapjen te pjesa tjetër e ekipit.

#### Atletico shpreh interesim për Lacazetten

Klubi spanjoll dëshiron blerjen e Alexandre Lacazettes. Sipas "Calcio Mercato", Atletico Madridi po e konsideron transferimin e Lacazettes gjatë afatit kalimtar të verës. Klubi spanjoll prej kohësh është në kërkim të një sulmuesi tipik dhe duket se i ka vënë syrin futbollistit të Arsenalit. Në anën tjetër, raportohet se "topçinjtë" nuk llogaritin më në sulmuesin francez dhe janë të hapur për shitjen e tij për një ofertë rreth 15 milionë euro. Trajneri i kampionëve të Spanjës është një admirues i lojës së 29-vjeçarit dhe po kërkon me çdo kusht ta ketë në ekip.

## Dështon në finale, por sjell medaljen e parë olimpike pas 21 vjetësh

Dejan Georgievski siguroi medaljen e parë olimpike pas pritjes 21-vjeçare të Maqedonisë. Georgievski në disiplinën e taekvondos arketoi medaljen e argjendit në Lojërat Olimpike në Tokio 2020, pasi që në finale të kategorisë nderi më 80 kg

u mund nga rusi Larin Vladislav me rezultat 15-9. Atleti rus nga fillimi e deri në fund kishte epërsi, duke mos lejuar për asnjë çast që Georgievski të shpresojë për medaljen e artë. 22-vjeçari Georgievski siguroi medaljen e 14-t

olimpike për Maqedoninë, duke humbur vetëm finalen e madhe. Në rrugën deri te medalja e argjendit në Lojërat Olimpike "Tokio 2020", Georgievski mundi Rafael Alban nga Kuba, Sejdu Gabane nga Bregu i Fildishtë

dhe në gjysmëfinale, sportistin nga Koreja e Jugut, Don Kjo In. Kujtojmë se medaljen e fundit nga Lojërat Olimpike për Maqedoninë, e siguroi mundësi Mogamed Ibragimov në Sidnej në vitin 2000, kur arketoi medaljen e bronzë.





**TrafikuUrban**

## K O N K U R S

- **Pozita e punës:** Asistent-e i/e Operativës (Ivend pune)
- **Kohëzgjatja e kontratës:** 1 vit me mundësi vazhdimi
- **Paga bruto:** Në bazë të Rregullores për Paga;

### Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Ndihmon Drejtorin e Operativës dhe Udhëheqësin e Transportit në punët e tyre të përditshme;
- Përpilon shkresa të cilat kërkohen nga Drejtori i Operativës dhe Udhëheqësi i Transportit;
- Asiston në çështjet teknike të zyrës;
- Pranon palët dhe vizitorët që i adresohen zyrës si dhe mbanë shënime për takimet e Drejtorit të Operativës lidhur me takimet brenda dhe jashtë;
- Bën ruajtjen dhe fajllimin e dokumenteve sipas kërkesave të DO-së;
- Bën pranimin e dokumenteve të punëtorëve nga Departamenti i Operativës drejtuar Burimeve njerëzore dhe shërben njëherit urë lidhëse ndërmjet tyre;
- Planifikon orarin e takimeve;
- Është përgjegjës/e për pranimin e palëve të DO-së, përkatësisht caktimit të terminëve për palët e treta;
- Kryen punë të tjera sipas kërkesës së udhëheqësve, të cilat për nga natyra i përkasin detyrave të punës;
- Mbanë evidencën e takimeve dhe procesverbalet e takimeve të Drejtorit të Operativës ashtu siç kërkohet;
- Planifikimi i takimeve dhe krijimi i ekupeve punuese ashtu siç kërkohet;
- Mirëmban marrëdhëniet me klientin dhe palët e treta.
- Ndërmerr detyra dhe përgjegjësi të tjera që mund të delegohen ose caktohen kohë pas kohe nga Drejtori i Operativës.
- Për punën e tij/saj i përgjigjet Drejtorit të Operativës.

### Kriteret e kërkuesit:

- Diploma universitare, Fakulteti Juridik, Administratë, Ekonomik, Menaxhment,
- Kopjen e Letërnjoftimit;
- Dëshmi nga Gjykata që nuk është nën hetime jo më të vjetër se 6 muaj;
- Shkathësi në komunikim dhe planifikim të punës;
- Shkathësi hulumtuese, analitike, vlerësuese dhe formulim të rekomandimeve dhe këshillave profesionale;
- Aftësi për përbushje të detyrave dhe punëve nën presion;
- Shkathësi kompjuterike të aplikacioneve të programeve (Word, Excel, Power Point, Access, Internetit)

### Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim:

- Kandidati/ja, duhet t'i dorëzojë këto dokumente në formë të skanuar në email: [punesimi@trafikurban-pr.com](mailto:punesimi@trafikurban-pr.com):
  - Aplikacioni për punësim (shkarkohet nga web-faqja e TU-së <http://www.trafikurban-pr.com/shq/job-aplikacioni-shq.html>;
  - Dëshmi mbi shkollimi;
  - Kopja e letërnjoftimit;
  - Dëshmi nga Gjykata kompetente që nuk është duke u zhvilluar procedurë penale ndaj tij/saj, jo më të vjetër se 6 muaj;
- Çdo përgënjeshttrim i materialit, qoftë i qëllimshëm ose nga neglizhenca ose ndryshim material nga informatat e dhëna në deklaratën e sipër cekur do të rezultojë në skualifikimin e menjëhershëm.

### Informata të përgjithshme:

- Ndërmarrja ofron mundësi të barabarta, inkurajon dhe promovon angazhimin e punëtorëve, pjesëtarë të të gjitha komuniteteve dhe të gjinive të ndryshme.

### Mënyra e Aplikimit:

Aplikimi mund të bëhet vetëm përmes emailit : [punesimi@trafikurban-pr.com](mailto:punesimi@trafikurban-pr.com)  
Konkursi është i hapur nga data **28.07.2021** dhe përfundon më datë **11.08.2021** në ora 24:00

**Vërejtje:** Dokumentet e pa kompletuara, të pa skanuara si dhe ato që arrijnë pas skadimit të afatit të konkursit nuk do të shqyrtohen.

NPK "Trafiku Urban" SHA  
Adresa: Rr. Tahir Zajmi, nr. 43 – Prishtinë, Kosovë  
web: [www.trafikurban-pr.com](http://www.trafikurban-pr.com) email: [info@trafikurban-pr.com](mailto:info@trafikurban-pr.com)  
tel: +383 45 10 11 33



**Republika e Kosovës**  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Qeveria – Vlada - Government

*Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës*  
*Ministarstvo Životne Sredine Prostornog Planiranja i Infrastrukture*  
*Ministry of Environment Spatial Planning and Infrastructure*

### Njoftim publik për konsultime në procedurën e fazës së I-rë për Kushtet Ndërtimore

**“Ndërtimi i objektit për banim, Fshati turistik në Prevallë në kuadër të Parkut Kombëtar “Sharri”.**

Në bazë të Nenit 12 paragrafi 2 dhe 3 të Udhëzimit Administrative Nr.01/2019 për lëshimin e Kushteve Ndërtimore për projektet e kategorisë së III.

Në lidhje me kërkesën paraprake për kushtet ndërtimore për projektin **“Ndërtimi i objektit për banim, Fshati turistik në Prevallë në kuadër të Parkut Kombëtar “Sharri”.**

Nr. prot: 2369/21 të datës 16.06.2021, zyrtari përgjegjës i nënshkruar më poshtë informon publikun për hapjen e procedurës së konsultimeve për projektin e propozuar dhe fton publikun të dorëzojnë komentet dhe pyetjet e tyre, brenda pesëmbëdhjetë ditësh nga data e këtij publikimi.

Komentet dhe pyetjet mund të dorëzohen në:

#### Posta rekomandë:

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës  
Departamenti i Planifikimit Hapësinor, Ndërtimit dhe Banimit  
Divizioni i Planifikimit Hapësinorë  
Ndërtesa e Rilindjes  
Kati i 14, zyra nr.1417, 10000 Prishtinë

Projekti mund të shkarkohet nga linku i mëposhtëm:

<http://mmp-hks.org/>

Për informata më të hollësishme mund të kontaktoni:

Suzana Goranci, Udhëheqëse e Divizionit të Planifikimit Hapësinor  
[Suzana.goranci@rks-gov.net](mailto:Suzana.goranci@rks-gov.net)  
Telefon: + 381 38 200 32 553

## >> SHPALLJE TË VOGLA <<

► D.P.T. "GLAMOUR 2" shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me numër fiskal: 600051619.

► Lëshoj banës me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.

► Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.

► Lëshoj banës me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.

► Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

► Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

► Urgjentisht kërkohet një banesë me qira në Prishtinë. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

► Lëshoj lokal në qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275

► Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanët me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.





Republika e Kosovës  
Republika Kosovo/ Republic of Kosovo

Këshilli Prokurorial i Kosovës/ Tužilački Savet Kosova/Kosovo Prosecutorial Council  
Sekretariati / Sekretarijat / Secretariat



Në bazë të nenit 31 të Ligjit Nr. 06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës, në bazë të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil të Kosovës, në bazë të Aktgjykimit nr. Ref AGJ.1583/20 të datës 09 Korrik 2020 si dhe Vendimit të Këshillit Prokurorial të Kosovës KPK/Nr. 193/2021 të datës 26 Mars 2021, Sekretariati i Këshillit Prokurorial të Kosovës, shpall këtë:

### KONKURS

- I. **Zyrtar për Transport 3**, dy (2) vende pune  
Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit, një (1) pozitë  
Zyra për Mbrojtje dhe Ndihmë Viktimave, një (1) pozitë

Referenca:	Kodi: KPK/SKPK/ZKPSH/PA/PSRK/PTH/ZMNV/POZ - 011
Emri pozitës:	Zyrtar për Transport 3
Pozita:	Pozitë e karrierës
Niveli:	Administrativ
Grada:	12
Raporton tek:	Administratori i Prokurorisë, Menaxheri i ZMNV- së
Numri i pozitave:	Një (1) pozitë
Koeficienti:	Pesë pikë pesë (5.5)
Akti i emërimit:	Pa afat
Puna Provuese:	Dymbëdhjetë (12) muaj
Vendi:	Prishtinë

#### Qëllimi i vendit të punës:

- Ofrimi i shërbimeve të transportit për prokurorë dhe stafin e Institucionit.
- Kujdeset për aktivitetet e drejtpërdrejta të lidhura me transportin në institucion dhe mirëmbajtjen e automjeteve.

#### Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore:

- Kryen punën e vozitjes së prokurorëve dhe stafit në bazë të orarit dhe caktimeve zyrtare, në nivel të prokurorisë;
- Mirëmban automjetin me të cilin kryen detyrat e punës apo me të cilin është i ngarkuar;
- Merr pjesë në planifikimin dhe përgatitjen e programit në fushën e transportit dhe siguron mbarëvajtjen e punëve lidhur me shërbimet e transportit;
- Është përgjegjës për sigurimin e servisimit dhe mirëmbajtjes së mjeteve transportuese të institucionit;
- Mban të dhënat për përdorimin, sevisimin e automjeteve dhe përgatit dokumentet e nevojshëm për përdorimin e tyre;
- Kujdeset që automjetet e institucionit të përdoren në mënyrë sa më racionale;
- Ofron shërbime të transportit sipas nevojave;
- Kryen edhe detyra tjera në pajtim me ligjet dhe rregulloret aktuale të cilat mund të kërkohen nga mbikëqyrësi.

#### Njohuritë, shkathtësitë aftësitë për vendin e punës:

- Njohuri të duhura profesionale për kryerjen e detyrës së zyrtarit për transport 3;
- Shkathtësi për të caktuar dhe vlerësuar punën sipas rëndësisë dhe prioritetëve;
- I gatshëm të punojë me njerëz të etnive dhe religjioneve të ndryshme;
- Të ketë gatishmëri për kryerjen e punëve nën presion;
- Shkathtësi në aplikacione të programeve Internet, Word, Excel.

#### Përgatitja profesionale dhe kualifikimi:

- Shkolla e mesme;
- Të posedojë patentë shofer për kategorinë "B".

#### Përvoja e Punës:

- Së paku 3 vite përvojë pune.

Konkursi është i hapur 15 ditë kalendrike nga dita e publikimit në faqen zyrtare të Sistemit Prokurorial të Republikës së Kosovës, si dhe në gazetën ditore, duke filluar nga data **28.07.2021 deri me datë 11.08.2021** si datë e mbylljes së konkursit.

- Kërkesa (aplikacioni) për punësim gjendet në web faqen: [www.prokuroria-rks.org](http://www.prokuroria-rks.org)
- Aplikacionet dorëzohen çdo ditë pune nga ora 08:00 deri në ora 16:00, në Divizionin e Burimeve Njerëzore, kati VII, Zyra Nr. 702, Prishtinë, Kosovë.
- Aplikimi përmes postës: Kërkesat e kompletuara me dokumente mund të dorëzohen edhe përmes postës në Divizionin e Burimeve Njerëzore të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës, adresa: Rr. "Luan Haradinaj", nr. 100, Kati 7, zyra nr. 702, 10000 Prishtinë.
- Aplikacionet e dërguara me postë, të cilat mbajnë vullën postare mbi dërgesën e bërë ditën e fundit të afatit për aplikim, do të konsiderohen të vlefshme dhe do të merren në shqyrtim, nëse arrijnë brenda 4 katër ditësh, aplikacionet që arrijnë pas këtij afati, dhe ato të pakompletuara nuk do të shqyrtohen fare.
- Në rast nevojë mund të na kontaktoni në, tel: 038/200 18874 prej orës 08:00 – 16:00.
- Kushtet e pjesëmarrjes në konkurs:
- Të drejtë aplikimi kanë të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës të moshës madhore të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, janë në posedim të të drejtave civile dhe politike, kanë përgatitjen e nevojshme arsimore dhe aftësinë profesionale për kryerjen e detyrave dhe të cilët kanë aftësi fizike që kërkohen për pozitën përkatëse.
- Sekretariati i Këshillit Prokurorial të Kosovës, ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë.
- "Komunitetet jo-shumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në organet e shërbimit civil të administratës publike qendrore dhe lokale siç specifikohet në nenin 11, paragrafi 3 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës."
- Aplikacionit duhet t'i bashkëngjiten kopjet e skanuara të dokumentacionit të kërkuar:
- Dëshminë e kualifikimit shkollor;
- Dëshmi mbi përvojën e punës, Vërtetimi dhe kontrata e punës (Letër Referenca apo Rekomandimi nuk pranohet si dëshmi mbi përvojën e punës);
- Dy rekomandime (nëse keni);
- Kopjet e dy raportëve të fundit të njëpasnjëshme të vlerësimit të punës (nëse ekzistojnë të tilla);
- Dokumentin e identifikimit-letërnjoftimi i fotokopjuar;
- Certifikatë nga Gjykata që nuk jeni nën hetime.



Republika e Kosovës  
Republika Kosovo/ Republic of Kosovo

Këshilli Prokurorial i Kosovës/ Tužilački Savet Kosova/Kosovo Prosecutorial Council  
Sekretariati / Sekretarijat / Secretariat



Na osnovu člana 31 Zakona Br. 06/L-056 o Tužilačkom Savetu Kosova, na osnovu Zakona Br.03/L-149 o Civilnoj Službi Republike Kosova i Pravilnika Br. 02/2010 o Procedurama Rekrutacije u Civilnoj Službi Kososva, Presude Ustavnog Suda Nr. ref. AGJ 1583/2020, datum 09 Jul 2020 kao i Odluke Tužilačkog Saveta Kosova TSK/Br. 193/2021 datuma 26 mart 2021, Sekretarijat Tužilačkog Saveta Kosova, objavljuje sledeće:

### KONKURS

- I. **Službenik za Transport 3**, dve (2) radna mesta  
Kancelarija Glavnog Državnog Tužioca, jedna (1) pozicija  
Kancelarija za Zaštitu i Pomoć Žrtvama, jedna (1) pozicija

Referenca:	Kod: KPK/SKPK/ZKPSH/PA/PSRK/PTH/ZMNV/ POZ -011
Naziv pozicije:	Službenik za Transport 3
Pozicija:	Pozicija karijere
Nivo:	Administrativno
Grada:	12
Raportira kod:	Administrator Tužilaštva/ Menađer KZPŽ
Broj pozicija:	Dve (2) pozicije
Koeficient:	Pet tačka pet (5.5)
Akt imenovanja:	Na neodređeno
Probni rad:	Dvanaest (12) meseci
Mesto:	Priština

#### Cilj radnog mesta:

Pružanje usluga prevoza tužioca službenika i osoblja institucije.  
Pažljiv za direktnim aktivitetima vezana za transport u instituciju i održavanje vozila.

#### Glavne obaveze i odgovornosti:

Završava posao vozača tužilaca i službenika na osnovu rasporeda službenih odredbi na nivou tužilaštva

Održava vozilo sa kojim završava službene obaveze ili sa kojim je zadužen  
Prisutan u toku planiranja za pripremu programa na polju transporta i obezbeđuje održavanje poslova vezano za usluge transporta

Odgovorani je za obezbeđenje servisa i održavanja transportnih vozila institucije;  
Drži evidenciju korišćenja, servisa vozila i spremi potrebnu dokumentaciju za njihovo korišćenje;

Stara se da vozilo institucije da se koriste na racionalan način

Pružna usluge transporta po potrebi;

Obavlja i druge zadatke u skladu sa aktualnim zakonima i pravilnicima koje može zatražiti od strane nadzornik.

#### Poznavanja, spretnosti i sposobnosti za radno mesto:

Potrebno profesionalno znanje za obavljanje zadataka Službenika za Transport 3;

Sposobnosti za određivanje i procenu posla po zadatim prioritetima ;

Spreman da radi sa ljudima raznih entiteta i religija ;

Da je spreman za obavljanje posla pod pritiskom ;

Sposobnosti korišćenja računara i programa Internet, Word, Excel.

#### Stručna sprema i Stručna sprema i kvalifikacija:

Srednja Škola

Vozačka dozvola kategorije "B" obavezna .

#### Radno iskustvo:

Najmanje 3 godine radnog iskustva.

Konkurs je otvoren 15 kalendarskih dana od dana objavljivanja na službenoj stranici Državnog Tužioca i Tužilačkog Saveta Kosova, kao i u dnevne novine, počevši od **28.07.2021 do 11.08.2021** kao datum isteka konkursa.

- Prijava (aplikacije) za zaposlenje dostupna je na Internetu: [www.prokuroria-rks.org](http://www.prokuroria-rks.org)
- Aplikacije se predaju svakog radnog dana od 08:00 do 16:00, u Diviziji Ljudskih Resursa, VII sprat, Kancelarija br. 702, Priština, Kosovo.
- Prijava poštom: Zahtevi popunjeni dokumentima takođe se mogu predati poštom Odeljenju za Ljudske Resurse Sekretarijata Tužilačkog Saveta Kosova, adresa: Rr. „Luan Haradinaj“, br. 100 Sprat 7, kancelarija br. 702, 10000 Priština.
- Aplikacije poslate putem pošte, koje sadrže poštanski pečat nad pošiljkom sa datumom poslednjeg dana roka za apliciranje, smatraće se važećim i uzeće se na razmatranje, ako stižu u roku od 4 dana, aplikacije koje stižu posle ovog roka ili su nekompletirane neće se uzeti u obzir uopšte.
- U slučaju potrebe možete da nas kontaktirate na, tel: 038 / 200 18874 od 08:00 do 16:00 časova.
- Uslovi učesća na konkursu:
- Pravo apliciranja imaju svi građani Republike Kosova odrasle dobi koji imaju punu sposobnost delovanja, poseduju civilna i politička prava, imaju potrebnu školsku spremu i stručne sposobnosti za vršenje dužnosti kao i fizičkih sposobnosti koja se traže za dotičnu poziciju.
- Sekretarijat Tužilačkog Saveta Kosova, pruža jednake mogućnosti zapošljavanja svim državljanima Kosova i dočekuje aplikacije od sviju osoba muškog i ženskog pola iz redova svih zajednica na Kosovu.
- "Nevećinske zajednice i njihovi pripadnici imaju pravo na pravedno i proporcionalno zastupanje u organima civilne službe centralne i lokalne državne administracije kao što je specifikovano članom 11, stav 3 Zakona br. 03/L-149 za Civilnu Službu Republike Kosova".
- Aplikacijama se moraju sastaviti kopije zatražene dokumentacije:
- Svedočanstvo školske spreme;
- Dokaz o radnom iskustvu; Potvrda i radni ugovor (Referentno pismo ili preporuka se ne prihvaćaju kao dokaz radnog iskustva).
- Dve preporuke (ako imate);
- Kopije dva poslednja naizmenična izveštaja procene rada (ako takvi postoje);
- Dokument identifikacije-fotokopirana lična karta;
- Uverenje od Suda da niste pod istragom.
- U vezi datuma održavanja pismenog testa i intervjua, za kandidate koji ispunjavaju uslove koji su predviđeni na osnovu ovog konkursa, kandidati biće obavesteni na osnovu važećeg zakonodavstva.





## ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

### Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Caseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales



## PASHTETË PULE

**MEKA**  
HALAL FOOD

gluten  
free



100% mish pule



cilësi e garantuar

pa konservues